REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES**
**KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

Nr. 2000 Prot.

Vau Dejës,me 25/11 /2020

## NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Bazuar ne ligjin 139/2015''Per vetëqeverisjen vendore''neni 18 pika 1 dhe pika 2, neni 54 germa(k) dhe në rregulloren e brendshme për funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës(VKB 23/2020),neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e Bashkisë Vau Dejës,grupet e interesit të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin e mëposhtëm:

- **"Për miratimin e Planit Social Vendor 2021-2023 për Bashkinë Vau Dejës"**paraqitur nga Sektori i Shërbimit Social pranë Bashkisë Vau Dejës.

Duke parë pamundësinë e realizimit të dëgjesës publike në ambjente të mbyllura apo të hapura, për shkak të COVID-19 (Akti Normativ nr.3 datë 15.03.2020 neni 5),ju ftojmë të gjithëve të bëheni pjesëmarrës në këtë konsultim të hapur online,duke komentuar dhe shprehur mendimet tuaja lidhur me projekt vendimin e mësipërme deri me datë 23.12.2020 në adresat: (info@vaudejes.gov.al , ardian.celepija@vaudejes.gov.al ,facebook - Këshilli Bashkiak Vau Dejës .)

( Projekt Vendimi është publikuar në WEB-in e Bashkisë Vau Dejës)

**SEKRETARI KËSHILLIT**

**Ardian ÇELEPIJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA VAU DEJËS**
**DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL ARSIMIT RINISE DHE SPORTIT**
**SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**
Adresa, *Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës* nr. Tel: *Telefon/Faks 00355 2612 0006*, e-mail *e-mail: info@vaudejes.gov.al*

Nr. 6742 prot. Vau Dejës, më 16, 11, 2020

**Lënda:** Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**Z. Mark Bisha**

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS**

**I nderuar zoti Kryetar,**

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, për:
"Për miratimin e Planit Social Vendor 2021-2023", i cili është përgatitur nga Esa Consulting me mbeshtetjen e UNICEF dhe të programit "Askush të mos mbetet pas" të Kombeve të Bashkuara.

Me respekt

**KRYETAR**
**MARK BABANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

**Konceptoi :**
Përgjegjës Sektori i Asistencës Ligjore
Kristinë Shtatri
**Miratoi:**
Çuka Babani: Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Social
Datë: ___________
Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: ____
Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: ____
Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA VAU DEJËS**
**DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL ARSIMIT RINISE DHE SPORTIT**
**SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**
Adresa, *Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës* nr. Tel: *Telefon/Faks 00355 2612 0006*, e-mail *e-mail: info@vaudejes.gov.al*

**PROJEKT VENDIM**

Nr. 5 datë 16.11.2020
**"Për miratimin e Planit Social Vendor 2021-2023"**

Në mbështetje të nenit 24, e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar ; Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e shqipërisë" VKM Nr. 150, datë 20.03.2019 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror". Kryetari i Bashkisë Vau Dejës me propozimin e Sektorit të Shërbimit Social , i propozon Këshillit të Bashkisë Vau Dejës , të :

**VENDOSI**

1. Miratimin e Planit Social Vendore 2021-2023.
2. Ngarkohet për zbatimin , Sektori i Shërbimit Social, pranë Bashkisë Vau Dejës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

**KRYETAR**
**MARK BABANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

**Konceptoi**
**Përgjegjës Sektori i Asistencës Ligjore**
**Kristinë Shtatri**

**Miratoi:**
**Pergjegjes i Sektorit te Sherbimeve Sociale**
**Çuka Babani**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA VAU DEJËS**
**DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL ARSIMIT RINISE DHE SPORTIT**
**SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL**
Adresa, *Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës* nr. Tel: *Telefon/Faks 00355 2612 0006*, e-mail *e-mail: info@vaudejes.gov.al*

Nr._______ prot. Vau Dejës, më___, ___, 2020

**RELACION**

Për hartimin e këtij plani jane realizuar takime dhe tryeza konsultimi me përfaqesuesit e :
Këshilli i Qarkut, Komisariatit i Policise Vau Dejës , Qendra Shëndetësore, Specialistë të Arsimit, Drejtues të shkollave 9-vjeçare dhe psikolog shkollash, Zyra e Punes, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Shoqata dhe Organizata ne nivel Bashkie dhe Qarku që kanë projekte në territorin e Bashkisë Vau Dejës, perfaqësies të Sektorit të Finances, Administrator Shoqerore, Urbanistikes, Burimeve Njërzore, Kryetar fshatrash , Administrator të Njësive Administrative, Punonjes Social dhe Punonjes për Mbrojtjen e Fëmijes, Koordinator të dhunes dhe të Strehimit Social, Anëtar të Këshillit Bashkiak/Komisioni që trajton çështjet sociale.

Bashkia Vau i Dejës do të garantojë shërbime komunitare të kujdesit shoqëror në përputhje me standartet kombëtare, për të përmirësuar jetën e çdo individi në situatë të pafavorshme, të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi, duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

Bashkia e Vaut të Dejës synon të ndërtojë shërbime komunitare të kujdesit shoqëror që adresojnë nevojat në ndryshim të individëve në rrezik nga varfëria apo përjashtimi social me qëllim fuqizimin, reabilitimin dhe riintegrimin e tyre në jetën ekonomike dhe sociale.

**Konceptoi :**
Përgjegjës Sektori i Asistencës Ligjore
Kristinë Shtatri
**Miratoi:**
Çuka Babani: Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Social

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

United Nations ALBANIA

unicef for every child

## BASHKIA VAU DEJËS




# PLANI SOCIAL

# 2021-2023

esa CONSULTING

Plani Social i Bashkisë Vau i Dejës u përgatit nga Esa Consulting me mbështetjen e UNICEF dhe të Programit "Askush të mos mbetet pas" të Kombeve të Bashkuara. Ky program është i angazhuar për të mbështetur reformën e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Shqipëri në përgjigje të përpjekjeve të qeverisë shqiptare për të mundësuar përfshirjen sociale të grupeve në nevojë.

Në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë qendrore ky program po mbështet Bashkitë për të zhvilluar, zbatuar dhe monitoruar Planet Sociale Lokale. Ligji nr. 121/2016 "Mbi shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" ngarkon Bashkitë me detyrën e përgatitjes së këtyre Planeve bazuar në nevojat e identifikuara për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e tyre. Edhe pse qeverisja lokale ka tashmë një nivel të ngritur të ndërgjegjësimit mbi nevojën për të ngritur e bërë funksional një sistem komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror për ata që kanë nevojë për këto shërbime, ajo ka kapacitete të kufizuara teknike dhe financiare për ti hartuar dhe kostuar planet e veprimit.

Objektivi i këtij programi katër vjeçar (2017 – 2021) është fuqizimi i personave dhe grupeve vulnerabël për të patur akses të barabartë në shërbimet publike, për të patur zë në vendimarrjet që ndikojnë mbi jetën e tyre dhe për të kërkuar përgjegjshmëri nga ata që kanë funksione publike. Grupet e targetuara drejtpërdrejtë ose indirekt nga shërbimet e përmirësuara sociale janë popullsia e margjinalizuar në Shqipëri, ku ndër grupet më vulnerabël janë më shpesh personat me aftësi të kufizuara, romët dhe egjiptianët, fëmijët dhe gratë. Përmirësimi i përfshirjes së tyre sociale po mbështetet nga ndërhyrje në nivelin makro (qeveria qendrore dhe shërbimet kombëtare), nivelit lokal (bashkitë dhe organizatat e shoqërisë civile) si dhe në nivelin mikro duke përfshirë aktivisht grupet e targetuara nga projekti në procesin e zbatimit të tij.

*Tetor 2020*

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

United Nations ALBANIA

unicef for every child

# PERMBAJTJA


HYRJE ... 4

1. MISIONI, VIZIONI DHE PARIMET UDHËRRËFYESE ... 6

1.1 Vizioni ... 6

1.2 Misioni ... 6

1.3 Parimet udhërrëfyese ... 6

2. ANALIZA E SITUATËS ... 8

2.1 Kuadri Strategjik ... 8

2.2 Nevojat, shërbimet e ofruara dhe mangësitë ... 12

2.2. 1. Vlerësimi i nevojave ... 12

2.2.2. Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve ... 17

2.2.3. Mangësitë - nevojat e paplotësuara ... 22

2.2.4. Analiza SWOT ... 27

3. QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET ... 30

4. PLANI I VEPRIMIT ... 48

5. MONITORIMI DHE VLERËSIMI ... 77

REFERENCAT ... 79

SHTOJCA 1: PROFILI DHE KARAKTERISTIKAT E KATEGORIVE NË NEVOJË PËR SHËRBIME TË KUJDESIT SHOQËROR ... 82

SHTOJCA 2. TREGUES TË SHËRBIMEVE EGZISTUESE ... 91

SHTOJCA 3. SHPORTA E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR ... 93

SHTOJCA 4. BUXHETI I DETAJUAR ... 97

## HYRJE

Bashkia Vau i Dejës ka një sipërfaqe prej 499,09 km2 dhe kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë Shkodër, në lindje me bashkinë Fushë Arrëz, në jug kufizohet me bashkitë Pukë dhe Lezhë. Ajo përbëhet nga njësitë administrative Vau i Dejës, Bushat, Temal, Shllak, Hajmel dhe Vig Mnelë. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 47 fshatra. Përqindjen më të lartë të popullsisë e gjëjmë në njësinë administrative Bushat (48%), në Vaun e Dejës dhe Temal gjejmë 30% të popullsisë, në Hajmel dhe Vig Mnele 18% dhe në Shllak vetëm 4% të popullsisë. Kjo Bashki ka 51,808 banorë, pjesë e 14,530 familjeve[1]. Numri mesatar i pjesëtarëve të familjeve në këtë Bashki është 3.5. Sipas Censusit numri i popullsisë në territor në vitin 2011 ishte 30,438 banorë. Pra vetëm 59% e popullsisë së rregjistruar në gjendjen civile banon fizikisht në këtë Bashki. Në këtë Bashki janë: (i) 13,574 fëmijë të grupmoshës 0-18 vjeç ( 26% ); (ii) 33,090 individë të grupmoshës 19-64 vjeç (64% ) ; (iii) 5,144 individë të grupmoshës mbi 65 vjeç (10%).

Aktivititeti kryesor ekonomik në këtë Bashki është bujqësia (ka aktivitet në eksportin e zarzavateve), blegtoria, biznesi i vogël dhe shërbimet. Kjo Bashki ka të zhvilluar sektorin energjitik me hidrocentralin e Vaut të Dejës, të Komanit, me HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2. Në Bashkinë e Vaut të Dejës ndodhet dhe Landfilli rajonal i Bushatit, që shërben si pikë grumbullimi dhe përpunimi i mbetjeve për rajonin Shkodër-Lezhë.

Bashkia Vau i Dejës konsideron të rëndësishëm planifikimin strategjik për shërbimet e kujdesit shoqëror jo thjesht sepse është detyrim që rrjedh nga legjislacioni kombëtar, por edhe për shkak të situatës së grupeve në nevojë në territorin e saj. E mbështetur nga UNICEF përmes programit "Leave No One Behind" dhe konsulentë të "ESA Consulting" struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror në këtë Bashki nisi në maj 2020 procesin e hartimit të Planit Social 2021-2023. Hartimit të këtij Plani i paraprinu Raporti i Vlerësimit të Nevojave për Shërbime të Kujdesit Shoqëror, i cili identifikoi grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë, madhësinë e këtyre grupeve, shtrirjen e tyre në territor, shërbimet egzistuese që adresojnë nevojat e tyre, si dhe kapacitetet e burimet njerëzore e financiare të Bashkisë për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Grupi lokal i Bashkisë i përbërë nga stafi i Sektorit Social, administratorët shoqëror në njësitë administrative, të mbështetur nga konsulenti kombëtar përdorën përgjatë procesit të identifikimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror kombinim të teknikave të ndryshme: (1) U analizua legjislacioni kombëtar për të identifikuar standartin udhërrëfyes në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror[2]. U kërkuan Plane strategjike të mundshme

[1] *Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile të 1 janarit 2020*
[2] *Tek Referencat gjeni listën e plotë të paketës legjislative të konsultuar*

lokale dhe procedura pune që ndiqen në këtë Bashki. U konsultua Rregullorja e Brendshme e Bashkisë për të identifikuar rolet dhe funksionet jo vetëm të strukturave egzistuese në Bashki në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, por edhe të njësive të tjera brenda Bashkisë me të cilat duhet ndërvepruar gjatë fazës së përgatitjes së Planit Social, si dhe duhen përfshirë më pas në fazën e zbatimit dhe monitorimit të Planit; (2) U identifikuan dhe u mblodhën një numër të dhënash satistikore dhe jo satistikore nga institucione kombëtare dhe lokale, si: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Administratorët shoqëror, Sektori Social, Rregjistri Elektronik Kombëtar i Ndihmës Ekonomike, Zyra e Punës, Strukturat Arsimore, Shëndetësore dhe Policia. Të dhënat u mblodhën në muajt Maj-qershor 2020. (3) Konsulentët e ESA Consulting analizuan të dhënat e mbledhura dhe përmes krahasimit me standartin kombëtar hartuan draftin e Raportit të Vlerësimit të Nevojave për Shërbime të Kujdesit Shoqëror. Raporti dhe gjetjet e tij fillestare u konsultuan në një tryezë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të (i) Qarku Shkodër: Këshilli i Qarkut, Drejtoria Rajonale e SHSSH Shkodër; (ii) Bashkia: Komisariati i Policisë, Strukturat arsimore, Zyra e Punës, struktura shëndetësore, këshilli Bashkiak, Sektori social, sektori i ndihmës ekonomike dhe PAK, zyra e financës, administratorë shoqëror, kryetarë fshati; (iii) organizata joqeveritare: "Gruaja te Gruaja", "Të ndryshëm dhe të barabartë", "Zyra për djem dhe burra", "Caritas Dioqezan", Qendra "Më dhuro një buzëqeshje", "Rreze shprese". Tryeza mundësoi saktësimin e të dhënave e gjetjeve të Raportit, si dhe identifikoi prioritetet për ngritjen e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Vau i Dejës. Në përputhje me: (1) vlerësimin e nevojave për shërbime në territorin e saj të identifikuara përmes të dhënave të mbledhura mbi individët dhe grupet në nevojë, (2) diskutimet me stafin dhe aktorët e tjerë, (3) shportën bazë të shërbimeve të kujdesit shoqëror[3], (4) burimet dhe kapacitetet që ka në funksion të adresimit të nevojave të këtyre grupeve, Bashkia Vau i Dejës përmes masave konkrete do të jetësojë prioritetet për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në territorin e saj, pjesë e këtij Plani Social.

Pavarësisht përpjekjes për të mbledhur të dhëna sa më të sakta e të plota për të identifikuar grupet në nevojë për shërbime në territorin e Bashkisë Vau i Dejës, ka një pranim të përgjithshëm nga të gjithë aktorët e përfshirë në proces se mund të egzistojnë në territor grupe të tjera në nevojë për shërbime, të cilat nuk u arritën të identifikohen për dy arsye kryesore: (1) Mungesa e të dhënave zyrtare për disa grupe në nevojë që edhe pse ekzistojnë, nuk rregjistrohen të dhëna për ta; (2) Mungesa aktuale e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në njësitë administrative që duhet të ushtronin funksionin e identifikimit, menaxhimit dhe referimit të rasteve në nevojë për shërbime. Kjo mungesë kufizon mundësinë për të punuar në mënyrë proaktive në territor e për rrjedhojë kufizon edhe saktësinë e të dhënave të mbledhura mbi të cilat është punuar e përgatitur ky Plan.

[3] *Sipas VKM 518, datë date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".*

Analiza e grupeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë Vau i Dejës flet për të paktën 6,045 individë, ose 11,6% të popullsisë, që kanë të nevojshëm të paktën një formë të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Duke qenë se, sipas të dhënave të Censusit 2011, 59% e individëve të rregjistruar në gjendjen civile jetojnë fizikisht në territorin e kësaj Bashkie, konkludojmë se referuar popullsisë fizike përqindja që zë grupi i individëve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror është më i lartë. Bashkia ka aktualisht të ngritur një formë shërbimi kujdesi shoqëror (shërbim rezidencial për të moshuarit), ndërkohë ka arritur të ndërtojë me sukses partneritetin me organizata të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime kryesisht për parandalimin dhe adresimin e dhunës në familje, si dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë, shërbimet e ngritura nga organizatat janë të bazuara tek financimi nga donatorët, gjë që i bën shërbimet të paqëndrueshme siç është rasti i shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara të cilat pas shumë vitesh aktivitet po shkojnë drejt mbylljes nga mungesa e financimit. Analiza tregoi se shërbimet e kujdesit shoqëror në tërësi në këtë Bashki (publike dhe jo publike) aktualisht janë të pamjaftueshme për të adresuar nevojat e identifikuara.

# 1. MISIONI, VIZIONI DHE PARIMET UDHËRRËFYESE

## 1.1 Vizioni

Bashkia e Vaut të Dejës synon të ndërtojë shërbime komunitare të kujdesit shoqëror që adresojnë nevojat në ndryshim të individëve në rrezik nga varfëria apo përjashtimi social me qëllim fuqizimin, reabilitimin dhe riintegrimin e tyre në jetën ekonomike dhe sociale.

## 1.2 Misioni

Bashkia Vau i Dejës do të garantojë shërbime komunitare të kujdesit shoqëror në përputhje me standartet kombëtare, për të përmirësuar jetën e çdo individi në situatë të pafavorshme, të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi, duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

## 1.3 Parimet udhërrëfyese

Ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes dhe kujdesit social do ta ketë bazën tek parimet universale të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë tek:

- *Parimi i universalitetit*. Shërbimet e kujdesit shoqëror do të krijohen, funksionojnë dhe mbikëqyren bazuar në një *sistem rregullash ligjore* që ofrojnë garanci të mjaftueshme për t'u zbatuar në mënyrë të njëjtë për përfituesit që ndodhen në të njëjtat kushte.

- *Parimi i drejtësisë sociale*. Çdokush ka detyrim të sigurojë kushtet bazë të jetesës për veten dhe personat për të cilët ka detyrim ligjor t'i mbështesë dhe çdokush ka detyrim të kontribuojë me punën, të ardhurat dhe pasuritë e tij/saj për reduktimin e gjendjes së varfërisë së tij/saj apo të anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre.

- *Parimi i subsidiaritetit.* Shërbimet e kujdesit shoqëror do të ofrohen *sa më pranë qytetarëve* dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore.

- *Parimi i mbështetjes shoqërore*. Subjektet, të cilat përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror, do të kenë të drejtën e përdorimit të tyre në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë.

- *Parimi i deinstitucionalizimit*. Shërbimet e kujdesit shoqëror do të sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve.

- *Parimi i partneritetit.* Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore do të bazohet në një *bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore*, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore me organizatat jofitimprurëse dhe subjektet e tjera jopublike, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët dhe familjet që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

- *Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit*. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror do të bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar dhe formimin e gjithanshëm të tij.

- *Parimi i mosdiskriminimit*. Do të ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

- *Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale*. Të dhënat personale të individit, që trajtohet me shërbime të kujdesit shoqëror, do të jenë konfidenciale dhe do të mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave

personale. Punonjësi social, si dhe çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror do të ruajë konfidencialitetin e të dhënave personale të individit për të cilat ka marrë dijeni si pasojë e funksionit apo detyrës që kryen. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit do të shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

## 2. ANALIZA E SITUATËS

### 2.1 Kuadri Strategjik

Në fushën e mbrojtjes dhe përkujdesit social politikat dhe strategjitë lokale duhet të formulohen në përputhje me nevojat e vlerësuara të individëve apo grupeve të rrezikuara nga varfëria apo përjashtimi social, si dhe duhet të udhëhiqen nga legjislacioni dhe standartet kombëtare. Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes sociale 2020-2023 dhe Plani i Veprimit të saj ka përcaktuar si një nga objektivat e tij ngritjen e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel kombëtar deri në vitin 2023[4]. Ky objektiv sipas strategjisë do të realizohet nëpërmjet: (i) Plotësimit dhe qartësimit të politikave që përcaktojnë reformën e programit të shërbimeve të kujdesit shoqëror; ii. Plotësimit të akteve nënligjore që do të hapin rrugën për zbatimin e reformës; iii. Përmirësimit të kuadrit institucional për strukturat përgjegjëse për programin e kujdesit shoqëror; iv. Krijimit të instrumenteve për hartimin dhe monitorimin e Planeve sociale vendore; v) Hartimit të instrumenteve si pjesë e kuadrit rregullator në ndihmë të autoriteteve rajonale/vendore; vi. Zbatimit të Fondit Social për të mbështetur kujdesin shoqëror përmes shërbimeve të reja dhe novatore."[5] Siç shihet për të ngritur sistemin kombëtar Strategjia parashikon ngritjen e sistemeve funksionale të integruara të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe shëndetësorë në njësitë e qeverisjes vendore. Për ti ngritur këto sisteme parashikohet së pari ngritja e strukturave/njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit për shërbime shoqërore në nivel vendor, si pjesë qendrore e drejtorive të mbrojtjes sociale, të cilat kanë detyrimin ligjor të hartojnë planet sociale vendore. Tërësia e planeve sociale vendore të zhvilluara në nivel lokal sipas përcaktimeve të ligjit të ri të shërbimeve sociale dhe integrimi i tyre do të përbëjë bazën për hartimin e hartës së shërbimeve shoqërore në shkallë kombëtare.

Ngritja e sistemeve komunitare të shërbimeve të kujdesit shoqëor është përgjegjësi e çdo Bashkie, kjo në përputhje si me Ligjin nr.13/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ashtu edhe me Ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë",

---

[4] *Vendim i Këshillit të Ministrave nr.866, datë 24.12.2019, "Për për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale,2020–2023, dhe të planit të veprimit në zbatim të saj.*

[5] *Vendim i Këshillit të Ministrave nr.866, datë 24.12.2019, Fq.21*

Sipas Ligjit nr.13/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" [6], neni 24, Bashkia ka funksionin e krijimit dhe administrimit të shërbimeve sociale në nivel vendor për shtresat në nevojë. Ligji nr.121, datë 21.11.2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij rregullojnë funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe në mënyrë të posaçme procesin e ofrimit të shërbimeve nga organet publike në nivel vendor të ngarkuara sipas Ligjit. Neni 36 i këtij Ligji ngarkon Bashkinë për të ofruar dhe administruar shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj duke: identifikuar nevojat; vlerësuar nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit; hartuar planin social vendor; programuar buxhetet vendore; planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore; kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik; bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar", në pikën 2 të tij ka përcaktuar këto forma të shërbimeve të kujdesit shoqëror: a) Shërbime parashoqërore, ku përfshihen informimi dhe këshillimi, ndërhyrja e hershme, këshillimi on-line; b) Shërbime në komunitet, ku përfshihen shërbimi në familje, alternativ, multifunksional, ditor dhe gjysmëditor, i emergjencës 72-orëshe, i strehimit të mbrojtur për të pastrehët; c) Shërbime rezidenciale afatgjata dhe shërbime të specializuara[7]. Kjo shportë shërbimesh është udhërrëfyese në ngritjen e sistemit komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror për Bashkinë e vendosur në kontekstin lokal sipas nevojave për shërbime të identifikuara.

Financimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror është gjithashtu i rregulluar tashmë nga ligji dhe aktet nënligjore të tij. Ligji 121/2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror", por edhe aktet nënligjore të miratuara në mbështetje të tij kanë kushtëzuar financimin nga qeveria qendrore të shërbimeve komunitare të Bashkisë me egzistencën e Planit Social të saj. Specifikisht pika 4.3 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.2.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social" përcakton se "Ministria përgjegjëse për çështjet sociale parashikon në buxhetin e saj fonde për financimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, të cilat u transferohen njësive të vetëqeverisjes vendore ku funksionojnë këto shërbime, bazuar në planet sociale të buxhetuara". Nënvizojmë se në përputhje me ligjin por dhe pikën 2 të VKM së lartpërmendur "Fondi social krijohet me burime financiare, nga: a) fondet e kushtëzuara që akordohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale; b) fondet nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara për shërbimet shoqërore; c) të ardhurat nga organizatat jofitimprurëse, individët e bizneset, si dhe donatorë të huaj e lokalë; ç) tarifat për shërbimet për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror."

---

[6] *http://www.qbz.gov.al/botime/permbledhese/pushteti%20vendor_varianti%20perfundimtar.pdf*
[7] *Nw Shtojcwn 3 gjeni tw detajuar shwrbimet e kujdesit shoqwror qw pwrfshihen nw kwtw VKM*

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 150, datë 20.03.2019 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror", ka përcaktuar mekanizmin e financimit nga Qeveria qendrore, si dhe metodologjinë e përllogaritjes së fondeve që do të furnizojnë Fondin Social që ngre Bashkia. Sipas këtij vendimi procedura e llogaritjes së financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror përfshin: (1) hartimin e Raportit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror, si dhe planin social të Bashkisë për periudhën trevjeçare. (2) Miratimin në Këshillin bashkiak të planit social trevjeçar të buxhetuar, si dhe kërkesës për financim nga buxheti i shtetit, brenda muajit shkurt të çdo viti, për atë pjesë të planit që mbetet i pambështetur nga buxheti i bashkisë. (3) Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, duke u bazuar në planet sociale vendore të buxhetuara dhe në prioritetet kombëtare për shtrirjen e shërbimeve shoqërore, parashikon në buxhetin e saj të vitit të ardhshëm, fonde për financimin e Fondit Social. Ky Vendim ka përcaktuar gjithashtu formatin e Raportit të Vlerësimit të Nevojave që i paraprin hartimit të Planit Social, sikurse dhe komponentët e këtij Plani të cilat janë mbajtur në konsideratë në ndërtimin e Planit Social të Bashkisë.

Për të ngritur sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror Bashkitë duhet të kenë jo vetëm buxhetin, por edhe burimet e nevojshme njerëzore për të përmbushur funksionet e parashikuara në ligj. Në përputhje me pikat 2 dhe 3 të nenit 36 të Ligjit 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë bashkive ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit. Konkretisht: (i)Struktura përgjegjëse në nivelin e Bashkisë përveç planifikimit, organizimit, prokurimit dhe monitorimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, duhet të përmbushë funksione që rrjedhin nga: Ligji 57/2019 "Për asistencën sociale"[8], Ligji 47/2018 "Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare"[9], Ligji[10]nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

Në përputhje me ligjin Ligji 47/2018 "Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare" njësitë e qeverisjes vendore kanë këto detyra: (i) angazhimin në krijimin e strukturave të shërbimit social për rastet e dhunës në familje; (ii) instalimin e një linje telefonike rajonale 24-orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe OJF-të, duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre; (iii) ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, si dhe koordinimin e punës me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse; (iv) Monitorimin e situatës së viktimës së dhunës në familje gjatë gjithë vlefshmërisë së urdhërit të mbrojtjes. Sipas VKM Nr.334, datë 17.2.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës

[8] *Ligji Nr.9355,datë 10.03.2005, ndryshuar me ligjin nr. 9602 datë 28.07.2006, ligjin nr. 10252 datë 11.03.2010, ligjin nr.25/2013, ligjin nr. 47/2014, ligjin nr. 44/2016 "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore".*

[9] *Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" të ndryshuar me Ligjin nr. 10 329, datë 30.9.2010.*

[10]*http://www.amshc.gov.al/ëeb/doc/ligjore/Ligj_18-2017_Per_Te_Drejtat_dhe_Mbrojtjen_e_Femijes.pdf*

për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij" struktura përgjegjëse e shërbimit të kujdesit shoqëror në Bashki duhet të ketë në përbërje të saj edhe koordinatorin vendor për adresimin e dhunës në familje. Në përputhje me VKM e sipërcituar Bashkitë kanë detyrimin për ngritjen dhe funksionimin e: (i) Komiteteve Drejtuese lokale që drejtohen nga Kryetari i Bashkisë dhe janë komitete koordinuese ad hoc; (ii) Ekipi teknik ndërdisiplinor që ngrihet me vendim të komitetit drejtues më qëllim bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse në nivel vendor në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje; (iii) Pranë çdo bashkie caktohet koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, i cili është përfaqësuesi i zyrës së shërbimeve sociale pranë asaj njësie të qeverisjes vendore;

Në këndvështrimin e garantimit të mbrojtjes që duhet ti mundësohet çdo fëmije, Ligji[11]nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" përcakton mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, bashkë me detyrat specifike që garantojnë ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave me efektivitet, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës. Në kreun III "Mekanizmat institucional për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", neni 34 grupi teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative përcaktohet si mekanizmi këshillimor dhe koordinues institucional në nivelin vendor. Sipas këtij ligji strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë: (i) Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki; (ii) Njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki; (iii) Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësive administrative; (iv) Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

Në çdo njësi administrative në varësi të Bashkisë, me përjashtim të Bashkive me më pak së 6 mijë banorë, ngrihet Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit[12], e cila siguron: (i) identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë; (ii) vlerësimin fillestar të nevojave dhe të riskut për individët në nevojë; (iii) informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla; (iv) hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes; (v) bashkërendimin e mbështetjes për individët dhe familjet në nevojë, dhe referimin tek shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal dhe qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm; (vi) përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit; (vii) mbikëqyrjen në vazhdim të ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimin mbi përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar. (viii) hedhjen e të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, në Regjistrin Elektronik Kombëtar sipas

---

[11] *http://www.amshc.gov.al/ëeb/doc/ligjore/Ligj_18-2017_Per_Te_Drejtat_dhe_Mbrojtjen_e_Femijes.pdf*
[12] *Nenet 36 dhe 37 të ligjit 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"*

përcaktimit të nenit 29, pika 2 të ligjit 121/2016. (ix) kryen funksione që lidhen me administrimin e pagesave cash të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar. Për të realizuar funksionet e përcaktuara Njësia për Vlerësimin dhe Referimin e Rasteve, duhet të ketë të paktën: një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6000 deri në 10 000 banorë; një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3000 fëmijë[13]; një administrator shoqëror[14];

## 2.2 Nevojat, shërbimet e ofruara dhe mangësitë

### 2.2. 1. Vlerësimi i nevojave[15]

***Individë* në *familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme***

7.2% e familjeve në Bashkinë Vau i Dejës përfitojnë ndihmën ekonomike. Specifikisht në prill 2020, përfituan ndihmën ekonomike përmes aplikimit të formulës së pikëzuar 935 familje dhe 112 të tjera përfituan nga fondi 6%. Ka një nivel të lartë të përfshirjes në skemën e ndihmës ekonomike të familjeve aplikuese në Bashkinë Vau i Dejës. 96% e familjeve aplikuese arritën të përfitojnë ndihmën ekonomike në prill 2020. Nga krahasimi i këtyre të dhënave me të dhënat e dhjetorit të vitit 2018, viti kur u aplikua për herë të parë modeli i ri i ndihmës ekonomike, shohim që kjo skemë nuk ka pësuar ndryshime të rëndësishme. Ky është tregues për mungesën e programeve të fuqizimit ekonomik të familjeve.

Shpërndarja e familjeve pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme në territor nuk është homogjene. Njësia administrative Shllak ka përqindjen më të lartë të familjeve në ndihmë ekonomike (49% e familjeve në këtë njësi jetojnë me ndihmë ekonomike), Hajmel dhe Vig Mnel kanë 26% të familjeve, Vau i Dejës dhe Temali 20% dhe Bushati vetëm 5%.

Karakteristikat kryesore të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike janë:

1. Familje me numër anëtarësh mbi mesataren e Bashkisë. Numri mesatar i pjesëtarëve në familjet përfituese të ndihmës ekonomike është 4,3, pra më i lartë se mesatarja në Bashki 3,5 anëtarë.

2. Predominojnë familjet me fëmijë të mitur. 50% e familjeve me ndihmë ekonomike kanë deri në 2 fëmijë të mitur dhe 24% e tyre kanë mbi 2 fëmijë.

---

[13] *Kjo në përputhje me Ligjin "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"*
[14] *Detyra sipas Ligjit "Për asistencwn sociale"*
[15] *Në Shtojcën 1 gjeni Treguesit e detajuar të analizuar*

3. Pjesëtarë persona me aftësi të kufizuara. 17% e familjeve përfituese të ndihmës kanë të paktën një pjesëtar me aftësi të kufizuar.

4. Gruaja kryefamijare. 6,8% e këtyre familjeve kanë gruan kryefamiljare

5. Të moshuar. 5.3% kanë të paktën një pjesëtar në moshë pensjoni.

Janë 4,525 individë pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. 40% e pjesëtarëve në familjet përfituese të ndihmës ekonomike janë fëmijë (1,799 fëmijë). Referuar numrit të përgjithshëm të fëmijëve në këtë Bashki del se 13% e tyre jetojnë në familje me të ardhura të pamjaftueshme.

Vetëm 1% e pjesëtarëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike i përkasin grupmoshës mbi 64 vjeç, pra 1% e individëve të kësaj grupmoshe jetojnë në familje me të ardhura të pamjaftueshme.

59% e pjesëtarëve të këtyre familjeve i përkasin grupmoshës 19-64 vjeç (2,659 individë). 8% e individëve të kësaj grupmoshe jetojnë në familje me të ardhura të pamjaftueshme. Ndërkohë janë sipas të dhënave të Zyrës së Punës janë 690 punëkërkues të rregjistruar nga Bashkia Vau i Dejës. 244 prej tyre (35%) janë pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Përqindja më e lartë e punëkërkuesve nga familje me ndihmë ekonomike është një njësinë administrative Vau i Dejës (49%). Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë faktin që numri i individëve të grupmoshës aktive për punë në familje me ndihmë ekonomike në këtë njësi administrative është 658 persona, konkludojmë se vetëm 32% e tyre janë të rregjistruar në Zyrën e Punës.

Karakteristikat e punëkërkuesve të papunë:

1. Më të vështirë për të siguruar një punë e kanë femrat se sa meshkujt. 59% e punëkërkuesve janë femra dhe 41% janë meshkuj.

2. Gra kryefamiljare. 6,6% e punëkërkuesve janë gra kryefamiljare.

3. Ka një nivel të ulët të rregjistrimit për punë të personave me aftësi të kufizuara. 0,9% janë persona me aftësi të kufizuara. Mungojnë analizat mbi arsyet që i mbajnë ata larg tregut të punës.

4. Më të vështirë sigurimin e një pune e kanë personat me moshë mbi 40 vjeç. 55% e personave në kërkim të një pune kanë moshë mbi 40 vjeç.

5. Mungesa e një profesioni është një arsye që nuk u krijon mundësi për punësim individëve të rregjistruar në Zyrën e Punës. Vetëm 10% e punëkërkuesve kanë arsim profesional ose të lartë.

Edhe pse zyrtarisht 8,7% e popullsisë në Bashkinë Vau i Dejës kanë të ardhura të pamjaftueshme dhe përfitojnë ndihmë ekonomike, intervistat dhe konsultimet e zhvilluara nxorrën në pah faktin që ka ende në territor familje të vafëra që nuk përfitojnë ndihmën ekonomike. Zonat më problematike u raportuan të jenë Hajmeli, Vau i Dejës dhe sidomos fshatrat më të thella. Arsyet për mospërfitimin e ndihmës janë të ndryshme: që nga lëvizjet migratore e deri tek mosraportimi i saktë nga familjarët i situatës ekonomike apo aseteve që zotërojnë. Mbetet i rëndësishëm fakti që nevojat për shërbime për familje pa ose me të ardhura të pamjaftueshme janë më të mëdha.

### *Persona me aftësi të kufizuara*

Në Bashkinë Vau i Dejës 1,8% e popullsisë (909 individë) kanë të paktën një formë të aftësisë së kufizuar sipas vlerësimit mjeksor dhe përfitojnë nga programi kombëtar i pagesave të aftësisë së kufizuar.

26% e tyre ka një formë të rëndë të aftësisë së kufizuar dhe për ta kujdeset një person ndihmës që gjithashtu përfiton pagesë nga programi kombëtar. 79% e personave me aftësi të kufizuara janë PAK fizik ose mendorë.

Përqindjen më të lartë të personave me aftësi të kufizuara e gjejmë në njësitë administrative Bushat (40%) dhe Vau i Dejës (30%). Në Hajmel jetojnë 13% e personave me aftësi të kufizuara. Në Temal, Shllak dhe Vig Mnel ka një përqindje më të ulët të tyre (4-7%).

Mes 909 personave me aftësi të kufizuara 12,4% janë fëmijë. Duke ju referuar totalit të 13,574 fëmijëve të rregjistruar në këtë Bashki, mund të themi se 0,8% e tyre kanë një formë të aftësisë së kufizuar dhe kanë të nevojshme shërbime zhvilluese/reabilituese. 43% e fëmijëve me aftësi të kufizuara jetojnë në njësinë administrative Vau i Dejës, 17% në Bushat, në Hajmel dhe Temal respektivisht 11% e tyre dhe në Vig Mnel 4%.

Nga programi kombëtar për aftësinë e kufizuar mbështeten gjithashtu në këtë Bashki 459 invalidë pune.

### *Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje*

1,923 fëmijë në Bashkinë e Vaut të Dejës u identifikuan në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje. Duke e krahasur më totalin të fëmijëve të rregjistruar në Bashkinë Vau i Dejës (13,574 fëmijë) mund të themi se në nivel Bashkie 14% e fëmijëve kanë të nevojshëm të paktën një formë shërbimi kujdesi shoqëror.

Të dhënat e strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashkinë Vau i Dejës japin këtë situatë për fëmijë në nevojë për shërbime:

- 8 fëmijë viktima të dhunës/shfrytëzuar
- 3 fëmijë me status jetimi
- 1,799 fëmijë në familje përfituese të ndihmës ekonomike
- 113 fëmijë me aftësi të kufizuara

Fëmijët në familjet përfituese të ndihmës ekonomike zënë peshën kryesore të fëmijëve në nevojë për shërbime. Mbështetja për ta duhet të jetë e koordinuar me masa që fuqizojnë pjesëtarët madhorë të familjeve të tyre.

Nuk u identifikuan raste të fëmijëve në konflikt me ligjin, fëmijë të shfrytëzuar për punë, apo fëmijë pa kujdes prindëror të përkohshëm.

Përqindjen më të lartë të fëmijëve në nevojë për shërbime e gjejmë në Shllak 47%, Hajmel dhe Vig Mnel 26% , Vau i Dejës dhe Temal 20% dhe më të ulët në Bushat (7%).

Megjithatë nga konsultimet rezultoi se numri i fëmijë në nevojë për mbrojtje pritet të jetë më i lartë se ai i raportuar. Mungesa e identifikimit proaktiv të rasteve në terren, si dhe niveli jo i duhur i ndërgjegjësimit të familjeve dhe komunitetit mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, veçanërisht në zonat më të thella të kësaj Bashkie, janë arsye që të çojnë në një konkluzion të tillë.

### *Viktimat e dhunës në familje*

Për të analizuar situatën e dhunës në familje në territorin e Bashkisë u kërkuan të dhëna për vitet 2018 dhe 2019 nga strukturat e Bashkisë, policisë dhe shëndetësisë. Stukturat e shëndetësisë nuk raportuan raste të dhunës në familje. Ndërkohë vihet re se ka ndryshime mes të dhënave të Policisë dhe atyre të raportuara nga Bashkia. Për vitin 2018 Policia raportoi 12 raste të dhunës në familje, ndërsa Bashkia raportoi 5 raste. Për vitin 2019 Policia raportoi 6 raste të dhunës në familje, Bashkia 14 raste.

Raste dhune janë raportuar në katër njësi administrative:

- 50% nga njësia administrative Vau i Dejës;
- 35% nga njësia administrative Bushat;
- 12% nga njësia administrative Hajmel;

- 3% nga njësia administrative Vig Mnel;

Dhuna në familje është raportuar në masën dërmuese nga gratë dhe në të dy vitet nga 26 viktima të dhunës së raportuar 2 viktima ishin burra.

Dhunuesit janë proceduar penalisht. Në vitin 2018 janë proceduar për veprën penale dhunë në familje 9 persona, nga të cilët 6 janë arrestuar dhe 3 në gjendje të lirë. Ndërsa në vitin 2019 janë arrestuar 3 persona.

Ka një pranim të përgjithshëm nga institucionet dhe organizatat që punojnë për parandalimin e dhunës në territorin e Bashkisë Vau i Dejës së rastet e dhunës janë më të larta se sa raportohet. Të pranuarit e dhunës si një çështje e vetë familjes, varfëria dhe pasiguria për jetën pas denoncimit të dhunës mendohet të jenë arsyet kryesore që dhuna nuk raportohet nga viktimat e saj. Edhe pse shifrat paraqesin një tjetër pamje për frekuencën e rasteve të dhunës punonjësit e policisë dhe strukturat e Bashkisë theksojnë se dhuna nuk raportohet më së shumti në njësitë administrative Vig Mnel, Shllak dhe Temal.

### *Në familje që kërkojnë mbështetje për strehim*

Mungojnë të dhëna mbi numrin e familjeve që kanë të nevojshëm mbështetjen për strehim social. Vlerësohet se në këtë Bashki janë të nevojshme fondet për rikonstruksion të banesave egzistuese të familjeve që për shkak të vështirësive ekonomike nuk e përballojnë koston e këtyre ndërhyrjeve.

### *Të moshuar në nevojë për shërbime*

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki raporton për 67 të moshuar që jetojnë vetëm dhe përfitojnë ndihmën ekonomike. Duke mbajtur në konsideratë që në Bashkinë Vau i Dejës janë të rregjistruar 5,144 persona me moshë mbi 65 vjeç, mund të themi se 1,3% e tyre kanë të nevojshme mbështetjen me shërbime specifike në kushtet që masa e ndihmës ekonomike është e ulët dhe jetesa për këta individë është më e vështirë.

11 të moshuar kanë kërkuar shërbim rezidencial për shkak të pamundësisë për të vijuar jetën në mënyrë të pavarur.

Të moshuar në nevojë për shërbime ka në çdo njësi administartive, por në përqindje më të lartë ata janë në Vaun e Dejës dhe Hajmel (respektivisht 28%). Në Vig Mnel janë 16%, në Temal 11%, Bushat 9% dhe Shllak 8%.

***Në familje që kanë përjetuar divorc***

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile gjatë vitit 2019 në këtë Bashki janë rregjistruar 97 divorce.

- 43% nga njësia administrative Bushat,
- 41% nga Vau i Dejës dhe Temal
- 16% nga Hajmel dhe Vig Mnele

***Përdorues të alkoolit***

Për vitin 2019 Policia ka raportuar 5 raste përdorues alkooli. Specifikisht 2 raste në Vaun e Dejës dhe nga 1 rast në Bushat, Hajmel dhe Vig Mnele.

### 2.2.2. Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve[16]

***Shërbime për familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme***

Shërbimet kryesore të identifikuara në lidhje me fuqizimin ekonomik të individëve në moshë pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike janë ato që ofron Zyra e Punës. Sipas të dhënave të kësaj Zyre ajo kombinon programet e nxjtjes së punësimit, këshillimin për punësim, kurset e formimit profesional dhe ofertat e punës për të adresuar nevojat për përfshirje në tregun e punës së punëkërkuesve (mes tyre individëve nga familje pa ose me të ardhura të pamjaftueshme) nga Bashkia Vau i Dejës.

U identifikuan disa sfida në punën me dhe për individët e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike: Shumica e personave nga Vau i Dejës e shohin vizitën në Zyrën e Punës si rutinë për të përmbushur detyrimin për të përfituar ndihmën ekonomike dhe jo si mundësi për punësim. Përgjithësisht nxjerrin arsye të ndryshme për të mos pranuar ofertën e punës, shpesh të paargumentuar. Ka gra që deklarojnë se nuk e pranojnë dot punën sepse burrat nuk janë dakort që ato të punojnë. Të tjerë nxjerrin arsye që lidhen me distancën e vendit të punës nga vendbanimi, por edhe kur biznesi i garanton transportin oferta e punës nuk pranohet. Pavarësisht nga refuzimi i ofertave të punës, Zyra e Punës nuk aplikon daljen e menjëherëshme të refuzuesve pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga sistemi,

---

[16] *Në shtojcën 2 gjeni të dhëna të tjera që lidhen me shërbimet*

por vijon ti këshillojë dhe të ofroj sërisht punësim në përputhje me mundësitë/pamundësitë e çdo individi për të pranuar punën.

Zyra e Punës ka një paketë kursesh formimi profesional që ua ofron individëve si një mundësi për të marrë një profesion. Kurset nuk janë specifike sipas karakteristikave të tregut të punës në territorin e Bashkisë Vau i Dejës.

Një tjetër sfidë e raportuar është distanca mes Zyrës së Punës dhe Bashkisë Vau i Dejës, që krijon kosto dhe vështirësi për individët punëkërkues të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike që duhet të paraqiten vazhdimisht pranë saj.

U identifikuan gjithashtu programe në zbatim për fuqizimin ekonomik përmes nismave të ndërmarra nga Qendra e Gruas "Hapat e Lehte" e cila po zbaton prej vitit 2018 në Bashkinë Vau i Dejës projektin "Gratë në Inisiativë" financuar nga Bashkimi Evropian. Gjatë zbatimit të këtij projekti në Bashkinë Vau i Dejës janë mbështetur nga skema e sub-granteve një organizatë joqeveritare dhe 5 grupe grashë me nje buxhet prej 44.333 EUR ne total. Projektet e mbështetura kanë në fokus të gjitha kategoritë, duke filluar që nga PAK, mosha e tretë, të rinjtë, shëndeti i qytetarëve, edukimit joformal, edukimi me shkathtësi profesionele pune dhe bisnesi, gjithmone duke i kushtuar vemendje te veçantë grave dhe vajzave të kësaj Bashkie. Po kjo organizatë po zbaton projektin "Aleanca për Zhvillimin e Bujqësisë Familjare në Veri të Shqipërisë" mbeshtetur nga AICS. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti janë mbështetur prodhues dhe transformues të prodhimeve bujqësore dhe blektorale të kësaj bashkie.

### *Shërbime për personat me aftësi të kufizuara*

Shërbimi shëndetësor është i shpërndarë në të gjithë territorin. Qendra shëndetësore ka në çdo njësi administrative, sikurse dhe 19 ambulanca, megjithatë mungojnë mjekët e specialiteteve dhe personat me aftësi të kufizuara për të marrë shërbimin duhet të udhëtojnë drejt Shkodrës ose Tiranës.

Personat me aftësi të kufizuara të grupmoshës mbi 18 vjeç duket se qëndrojnë larg Zyrës së Punës. Vetëm 6 persona me aftësi të kufizuara (0,7% e PAK) janë të rregjistruar si punëkërkues në këtë Zyrë. Nuk ka një vlerësim të mirëfilltë të këtij niveli shumë të ulët të kërkesës për punë nga personat me aftësi të kufizuara.

Për personat me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç "Caritasi Dioqezan Sapa" ka punuar përmes projekti "Instalim, rrjetëzim dhe rritje kapacitetesh përmes këshillimit ligjor dhe ndërhyrjes strategjike të unifikuar lidhur me nevojat e personave me aftësi të kufizuara". Projekti është zhvilluar në katër drejtime kryesore (1)Ngritja e qendrës Këshillim Social dhe Ligjor; (2) Këshillim mes të barabartëve (metoda "peer to peer"); (3) Advokim, lobim për të drejtat e

personave me aftësi të kufizuara dhe (4) Monitorim i zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për PAK (2016-2020 ). Përmes këtij projekti është mundësuar trainimi i vetë personave me aftësi të kufizuara për të ofruar këshillim për të tjerë persona me aftësi të kufizuara. Organizata është duke përgatitur një kurikul trainimi, që të mundësojë njohjen e profesionit të konsulentit "peer to peer". Në kushtet që financimi i këtij projekti përfundon në gusht 2020, sugjerohet që ky model dhe qendra e këshillimit social të vijoj të zbatohet nga vetë Bashkia e Vaut të Dejës.

Ndërkohë Qendra "Vëllezërit e Nënë Terezës" në Bushat mundëson shërbim rezidencial për 30 persona me aftësi të kufizuara. Theksojmë se në territorin e Bashkisë Vau i Dejës nuk janë identifikuar raste të braktisjes së personave me aftësi të kufizuara nga familjarët e tyre.

Për fëmijët me aftësi të kufizuara në këtë Bashki janë ngritur dhe kanë funksionuar nga organizatat joqeveritare dy qendra: (1) "Rreze shprese" ka ofruar shërbime për fëmijë me çrregullime të spektrit të autizmit. Qendra ka funksionuar mbi bazë projektesh të mbështetura nga donatorë të ndryshëm. Shërbimet me logoped, psikolog, terapitë e zhvillimit janë ofruar për fëmijë në Vaun e Dejës. Edhe pse infrastruktura e shërbimit është e ngritur për mungesa në financim, qendra ka ndërprerë aktivitetin. (2) Qendra "Mark Quni" ka ofruar shërbim gjysëm ditor për fëmijë me aftësi të kufizuara, por për mungesë financimi edhe kjo qendër po shkon drejt mbylljes.

***Shërbime për fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje***

Shërbimet për fëmijët në nevojë për mbrojtje e kanë zanafillën tek identifikimi dhe menaxhimi i rasteve. Në këndvështrimin e identifikimit të rasteve shtrirja e territorit, zonat shumë të thella dhe egzistenca e vetëm një punonjëseje të mbrojtjes së fëmijës ka vështirësuar punën në territor për ti identifikuar rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, apo punën ndërgjegjësuese me familjet dhe komunitetin për të njohur e respektuar të drejtat e fëmijës. Nevojat më të mëdha për të punuar për ndërgjegjësimin e familjeve mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve u raportuan në njësitë administrative Shllak dhe Temal.

Grupet teknike funksionojnë sa herë ka raste për të menaxhuar. Problem mbetet mungesa e shërbimeve dhe veçanërisht për zonat më të thella të Bashkisë. Nëse prindërit duan të punojnë mungesa e shërbimeve, pamundësia për të lënë fëmijët në përkujdesje në kohën që ata punojnë, ua heq mundësinë për të pranuar ofertën e punës. Ka familje që nuk perballojnë dot koston e transportit dhe mbeten pa shërbime.

Në Bashkinë Vau i Dejës nuk ka asnjë çerdhe. 16 Kopshtet ofrojnë shërbim gjysëm ditor për 669 fëmijë dhe janë pa pagesë.

2593 fëmijë mësojnë në 26 shkollat 9 vjeçare të kësaj Bashkie dhe shërbimi psikologjik mundësohet nga vetëm 2 psikologë. Ky shërbim është i pamjaftueshëm. Për fëmijë me aftësi të kufizuara në shkolla ka mësues ndihmës, por jo të specializuar për punën me këta fëmijë.

824 fëmijë ndjekin arsimin e mesëm në 6 shkollat e mesme të kësaj Bashkie. Shërbimi psikologjik në shkolla i pamjaftueshëm.

Bashkia ndjek një praktikë pune ndërveprimi me organizatat dhe shkollat për të punuar për ndërgjegjësimin e fëmijëve.

Shërbimi i kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror nuk është i ngritur dhe për menaxhimin e rasteve emergjente Bashkia Vau i Dejës ndërvepron me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shkodër për të aksesuar shërbimet në nivel qarku apo nivel kombëtar.

***Shërbime për viktimat e dhunës në familje***

Në shkurt 2020 është formësuar Komiteti Drejtues, që koordinon përpjekjet për parandalimin e dhunës dhe adresimin e nevojave të viktimave të saj. Në vijim institucionet kanë caktuar punonjësin e tyre si pjesë të ekipit teknik ndërdisiplinor, por pjesa dërmuese e tyre nuk janë të trainuar për çështjet e dhunës në familje.

Koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje raportoi disa sfida në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje: (i) nivel i ulët ndërgjegjësimi për ta raportuar dhunën. Bashkia ka zhvilluar fushata ndërgjegjësimi, por kryesisht në zonat me popullsi më të madhe dhe jo në zonat e thella. (ii) vështirësitë ekonomike, mungesa e shërbimeve dhe pasiguria e viktimës çon shpesh në situata të tërheqjes së denoncimit prej tyre. (iii) Ambjentet e punës nuk janë të përshtatura për nevojat e komunikimit me një viktimë dhune. Kontakti i parë i viktimës është me policinë dhe jo me strukturën e Bashkisë. (iv) Ka dy muaj që Ministria ka sjell një protokoll për menaxhimin e rasteve, por ka vështirësi në menaxhimin e tyre për shkak të distancës, por edhe mungesës së shërbimeve. Nuk ofrohet transport falas për viktimën e dhunës në familje kur ka të nevojshëm aksesin tek shërbimet, sidomos tek ato që janë në Shkodër. Mungesa e shërbimeve për fëmijët e tyre vështirëson mundësinë e punësimit të tyre. Zyra e Punës dhe formimi profesional janë në Shkodër, shumë larg për viktimat e dhunës që jetojnë në zonat e thella të kësaj Bashkie. Edhe këshillimi psikologjik e ligjor është në Shkoder.

Janë dy organizata që punojnë me projekte për ofrim shërbimesh e fuqizim ekonomik për viktimat e dhunës në këtë Bashki:

Qendra e Gruas "Hapat e lehtë" prej vitit 2019 ofron shërbim psikosocial dhe ligjor për viktimat e dhunës në këtë Bashki. Ajo është pjesë e mekanizmit të referimit të dhunës në këtë

Bashki. Gjatë periudhës janar-prill 2020 ka ofruar shërbim për 8 viktima dhunë në familje, ka mbështetur 2 raste emergjente dhe në proces divorci janë 4 raste. Projektet e saj për fuqizim ekonomik në këtë Bashki targetojnë gjithashtu viktimat e dhunës në familje.

"Gruaja tek Gruaja" është gjithashtu pjesë e mekanizmit lokal kundër dhunës në familje. Strehëza e emergjencës 72 orëshe është e aksesueshme për çdo rast të referuar nga mekanizmi vendor në këtë Bashki. Ndërkohë përveç këshillimit psikologjik për viktimat e dhunës, qendra ofron shërbim reabilitues edhe për dhunuesit. Me mbështetjen e UNDP kjo organizatë nisi në korrik 2020 zbatimin e një tjetër projekti 1 vjeçar në Bashkinë Vau i Dejës për fuqizimin e mekanizmit të koordinuar të referimit për rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare.

***Shërbimi i strehimit social***

Në vitin 2018 Bashkia e Vaut të Dejës përmes një financimi të qeverisë qendrore mundësoi zëvendësimin e çative me eternit të 150 banesave. Bashkia do të vijoj me këtë ndërhyrje në sajë të financimit të fazës së dytë të këtij projekti. Aktualisht Bashkia për mungesë fondesh nuk aplikon asnjë formë të strehimit social.

***Shërbime për të moshuarit***

Me mbështetjen financiare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është ngritur dhe funksionon një shërbim rezidencial për të moshuarit. Aktualisht në këtë qendër marrin shërbim rezidencial 20 të moshuar. Bashkia ka mbështetur me pako ushqimore sipas emergjencës të moshuar veçanërisht gjatë periudhës së Pandemisë së Covid-19.

***Shërbime për familjet që kanë përjetuar divorc***

Mungojnë shërbime specifike për pjesëtarë të familjeve që kanë përjetuar divorc.

***Shërbime për përdorues të alkoolit***

Mungojnë shërbime specifike për përdorues alkooli.

### 2.2.3. Mangësitë - nevojat e paplotësuara

Bashkia Vau i Dejës ka ngritur vetëm një formë shërbimi publik, shërbimin rezidencial për të moshuarit. Ndërkohë, organizata jo qeveritare kanë ngritur forma shërbimi kujdesi social, një pjesë e të cilave edhe pse janë drejt mbylljes për shkak të pamundësive financiare, janë për Bashkinë një mundësi për ti zhvilluar në vijim këto modele shërbimi që kanë egzistuar dhe që janë të nevojshme. Partneriteti që duhet të forcojë e zhvillojë më tej me institucione lokale e rajonale dhe organizata e ofrues shërbimesh në territor dhe në nivelin e qarkut do ti japë mundësinë Bashkisë Vau i Dejës të maksimalizojë burimet dhe kapacitetet për të ngritur një sistem komunitar shërbimesh kujdesi shoqëror që adresojnë nevojat e individëve në situatë të pafavorshme në këtë Bashki.

Mangësitë aktuale i përkasin dy drejtimeve kryesore: 1. Mungesa në burime njerëzore dhe kapacitete të Bashkisë për të ngritur dhe bërë funksional sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe 2. Mangësitë në shërbime të kujdesit shoqëror të vlerësuara mbi bazën e nevojave të individëve të identifikuar që duhet ti marrëin këto shërbime.

#### *2.2.3.1. Mangësitë në burime njerëzore dhe kapacitete të Bashkisë*

Struktura përgjegjëse për mbrojtjen dhe përkujdesin social në Bashkinë e Vaut të Dejës është Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit. Kjo drejtori është e organizuar në tre sektorë: (i) sektori i ndihmës ekonomike dhe PAK; (ii) sektori i shërbimit social; (iii) sektori i Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Shëndetësisë[17].

Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe PAK përbëhet nga përgjegjësi i sektorit dhe 8 specialistë/administrator shoqëror që administrojnë programin e ndihmës ekonomike dhe PAK në 6 njësitë administrative të kësaj Bashkie. Përshkrimet e punës së tyre, pjesë e Rregullores së Bashkisë, janë në përputhje me parashikimet e ligjit "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".

Sektori i shërbimit social drejtohet nga përgjegjësi i sektorit dhe ka tre specialistë që përmbushin funksione që rrjedhin nga të paktën pesë ligje: (i) ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" (specialist i përfshirjes sociale me detyrat e përcaktuara në nenin 81 të Rregullores); (ii) Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" ( Specialisti psikolog dhe mbrojtjes së fëmijëve me detyrat e përcaktuara në nenin 82 të Rregullores); (iii) Ligji "Për barazinë gjinore" dhe Ligji "për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare" (Koordinatori për rastet e dhunes në familje me detyrat e përcaktuara në nenni 83 të Rregullores); (iv) Ligji "Për strehimin Social" (specialisti i Strehimit me detyrat e përcaktuara në nenin 84 të Rregullores).

---

[17] *Shih shtojcën 2*

**Sfidat e identifikuara:**

*1. Personel i limituar për menaxhimin e rasteve sociale*

Mungon lidhja mes dy sektorëve për menaxhimin e rasteve të individëve në nevojë për shërbime. Menaxhimi i rasteve përballohet nga sektori i shërbimit social që përballë nevojës për identifikim proaktiv të rasteve dhe menaxhimit në vijimësi të tyre është shumë i kufizuar në numër dhe kapacitete. Në përputhje me detyrimet ligjore të dy sektorët: ndihma ekonomike dhe shërbimi social duhet të kishin në nivelin e njësive administrative ekipet e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit me personelin që jepet në tabelën 1.

*Tabela 1: Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit sipas ligjit*

| NJESIA ADMINISTRATIVE | TE DHENAT REFERENCE | | | | NJESIA E VLERESIMIT TE NEVOJAVE DHE REFERIMIT | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. Banorë | Nr. Fëmijë | Nr.familje NE | Nr. Individ PAK | Punonjës Social | PMF | Administrator shoqëror |
| Vau i Dejës | 15,749 | 4,317 | 272 | 277 | 1 | 1 | 2 |
| Temal | | | 149 | 61 | | | 1 |
| Bushat | 24,934 | 6,205 | 151 | 363 | 2 | 2 | 2 |
| Hajmel | 9,169 | 2,406 | 207 | 116 | 1 | | 1 |
| Vig Mnele | | | 120 | 39 | | | 1 |
| Shllak | 1,956 | 646 | 148 | 53 | | | 1 |
| **TOTALI** | **51,808** | **13,574** | **1,047** | **909** | **4** | **3** | **8** |

Në përputhje me parashikimet ligjore në nivelin e njësive administrative sektori i shërbimit social duhet të mbështetej në menaxhimin e rasteve nga 4 punonjës social dhe 3 punonjës të mbrojtjes së fëmijës, të cilët duhet të punojnë si ekip bashkë me administratorët shoqëror. Këto ekipe nuk janë ngritur.

*2. Mungesa në infrastrukturë e buxhet për menaxhimin e rasteve*

Stafi punon në një ambjent të përbashkët, të papërshtatshëm për nevojat e punës me grupe vulnerabël në tërësi dhe në veçanti punës me fëmijët dhe viktimat e dhunës në familje. Lëvizja nëpër fshatra për menaxhimin e rasteve shumë e vështirë për shkak të shtrirjes së gjerë gjeografike. Nuk ka buxhet të dedikuar për menaxhimin e rasteve, kostot përballohen nga vetë punonjësit.

*3. Niveli i lartë i varfërisë dhe mungesa e shërbimeve*

Ka një numër të lartë rastesh në nevojë për shërbime, ndërkohë që ka mungesa në shërbimet që mund të adresojnë nevojat e tyre.

*4. Nevoja për ngritje kapacitetesh*

Janë të nevojshme trainimet në të dy nivelet (Bashki dhe njësi administrative) për njohjen e legjislacionit në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe menaxhimin e rasteve. Në mënyrë të veçantë për: qartësim i rolit të punonjësit social ; mekanizmat për fuqizimin ekonomik të familjeve; Menaxhimi i rasteve të dhunës në familje (trainimet duhet të përfshijnë të gjitha institucionet pjesë e mekanizmit; Strehimi social.

### *2.2.3.2. Mangësitë në shërbime të kujdesit shoqëror*

- ***Për 2,659 individët në moshë pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike janë të nevojshme ndërhyrje në dy drejtime kryesore:***

*1. Informimi dhe këshillimi* i vazhdueshëm për punësim per përmirësimin e situatës së individit, duke i orientuar rreth mundësive më të përshtatshme për nevojat e tij. Zyra e Punës bashkë me administratorin shoqëror të njësisë administrative respektive të zhvilloj dy herë në vit takime të tilla me individëv në moshë pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike në ambjentet e njësisë administrative;

*2. Program për fuqizimin ekonomik.* Pjesë e programit duhet të jenë të paktën : ngritje e rrjetit ndërinstitucional që nxit punësimin e individëve vulnerabël në Bashkinë Vau i Dejës; identifikim i karakteristikave të tregut të punës dhe zhvillim i kurseve profesionale sipas këtyre karakteristikave; ndërtimi i partneritetit me organizata për ngritjen e ndërmarrjeve/bizneseve sociale.

- ***Për 796 persona me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç janë të nevojshme:***

*1.* Duhet të vijoj praktika e ngritur *e këshillimit social e ligjor* për personat me aftësi të kufizuara. E rëndësishme është gjithashtu nxitja e ndërgjegjësimit si të personave me AK dhe e punëdhënësve për punësimin e tyre. Mund të modelohen forma të biznesit social për këtë qëllim.

*2. Shërbime rehabilituese* per personat në nevojë për aftësim fizik;

*3. Shërbimet në familje* për persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime komunitare, e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal;

- ***Për 1,923 fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje janë të nevojshme:***

*1. Mekanizmi lokal për identifikimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje duhet përforcuar.* Mekanizmi duhet të ndërmarrë fushata informimi e ndërgjegjësimi edhe në komunitet, veçanërisht në zonat më të thella të Bashkisë.

*2. Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line,* shërbim i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës. Duhet të jetë pjesë e sistemit për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve.

*3. Shërbim psikologjik e kurse prindërimi për familjet biologjike, por edhe familjet e mundshme kujdestare.*

*4. Qendër ditore per fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike*; Qendra duhet të menaxhoj edhe rastet e emergjencës, sikurse rastet e fëmijëve të familjeve ekstremisht të varfëra duke mbështetur sipas nevojave emergjente me pako ushqimore apo higjenike.

5. *Qendër ditore per fëmijë me aftësi të kufizuara, që ofrojnë shërbime zhvilluese e reabilituese për fëmijë në qendër dhe pranë familjes.*

- ***Për të paktën 150 viktima të dhunës në familje janë të nevojshme:***

*1. Mekanizmi lokal për identifikimin e rasteve të dhunës duhet përforcuar.* Mekanizmi duhet të ndërmarrë fushata informimi e ndërgjegjësimi në komunitet, veçanërisht në zonat më të thella të Bashkisë ku dhunë ka por nuk raportohet.

*2. Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line,* shërbimi duhet të ofrohet nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;

*3. Shërbimi i emergjencës 72 orë për v*iktima të dhunës në familje dhe fëmijët që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situate që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur.

*4.Shërbimi i strehimit të mbrojtur/strehim social per* viktimat e dhunës në familje, viktimave të trafikimit të cilët nuk kanë një strehë.

5. Programet për *fuqizimin ekonomik* duhet të targetojnë edhe viktimat e dhunës në familje.

*6. Shërbim reabilitimi për dhunuesin.*

- ***Për të paktën 78 të moshuar:***

*1. Shërbimi rezidencial duhet të plotësohet me shërbimet në familje* për të moshuar të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, pasi nuk kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal.

- ***Për të paktën 97 familje që përjetojnë divorc dhe 30 përdorues alkooli:***

*1. Shërbim psikosocial dhe shërbime të tjera mbështetëse e fuqizuese sipas nevojave të identifikuara.*

- ***Për të gjitha grupet në nevojë të identifikuara në përputhje me nevojat e vlerësuara për strehim social:***

Kur është e nevojshme duhet ofruar shërbimi i *bonusit të qerasë apo banesave sociale* me pagesë të reduktuar.

### 2.2.4. Analiza SWOT




### Pikat e forta

***1. Motivim i lartë***

Drejtuesit e Bashkisë, personeli i strukturës përgjegjëse aktuale për shërbimet sociale në këtë Bashki dhe në njësitë administrative, sikurse dhe aktorë të ndryshëm lokalë të konsultuar përgjatë fazave të përgatitjes së Planit Social demonstruan vullnet, motivim dhe qartësi të plotë për nevojën për të ngritur dhe bërë funksional sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në këtë Bashki.

***2. Koordinim i mirë mes aktorëve publikë e jopublik***

Bashkia Vau i Dejës ka ndërtuar partneritetin me institucione kyç si Zyra e Punës, strukturat arsimore dhe Policia, sikurse me organizata joqeveritare dhe ofrues shërbimesh që janë një bazë e rëndësishme për zbatimin e disa prej masave thelbësore të parashikuara në Planin Social. Ky partneritet i ngritur duhet të zgjerohet edhe me institucione të tjera publike dhe jopublike, sipas parashikimeve në këtë plan apo zhvillimeve në vijim në periudhën e zbatimit të tij, me qëllim funksionimin efiçent të sistemit të dizenjuar sipas këtij Plani.

***3. Egzistenca e modeleve për disa tipe shërbimesh***

Për formësimin e programit të fuqizimit ekonomik, për shërbimet për viktimat e dhunës në familje dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara egzistojnë modele dhe praktika të ngritura nga institucione partnere apo ofrues jopublik shërbimesh, që janë një bazë shumë e rëndësishme e që lehtëson punën e ekipit social të Bashkisë në procesin e zbatimit të Planit.

## Pikat e dobëta

### *1. Mungesa në burime njerëzore*

Analiza e organizimit të Bashkisë në të dy nivelet tregoi se ka nevojë jo vetëm për shtimin e personelit, por edhe për rishikimin e roleve dhe përgjegjësive si të strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashki, ashtu edhe të njësive administrative ku duhet të funksionojnë Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit. Kjo do të kërkojë si buxhet shtesë, ashtu edhe rishikim të Rregullores së Bashkisë e trainim të personelit për t'ju përgjigjur cilësisht detyrave funksionale.

### *2. Mungesa në buxhet*

Në kushtet e mungesës së Planit Social, Bashkia nuk ka parashikuar në programin buxhetor afatmesëm fonde për financimin e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror. Ndërkohë mungesat në buxhet limitojnë edhe kapacitetet e strukturave të shërbimit social në të dy nivelet për të menaxhuar rastet sociale.

## Mundësitë

### *1. Kuadri ligjor i plotë*

Egziston tashmë një kuadër ligjor i plotë që rregullon ngritjen dhe funksionimin e sistemeve komunitare të kujdesit shoqëror. Aktet nënligjore të Ligjit 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" kanë përcaktuar qartësisht sistemin e rregullave për ngritjen e shërbimeve komunitare për grupet në nevojë për shërbime, për mekanizmin e financimit të shërbimeve, sikurse edhe për burimet njerëzore që duhet të egzistojnë në funksion të këtij sistemi. Për shërbimet e kujdesit shoqëror egzistojnë standarte kombëtare të miratura që janë baza mbi të cilën do të ngrihen tipet e shërbimeve që përmban Plani Social i Bashkisë.

### *2. Mbështetje e donatorëve*

Bashkia ka demonstruar kapacitet për të thithur fonde për ngritje shërbimesh. Shërbimi rezidencial për të moshuarit është ngritur përmes aplikimit për fonde pranë Ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.

### *3. Partneriteti i ngritur me ofrues shërbimesh*

Bashkia ka partneritet të ngritur gjithashtu me disa organizata që kanë shprehur angazhim për tu përfshirë në procesin e zbatimit të Planit Social.

### *4. Eksperienca dhe praktika të ngjashme*

Bashkia Shkodër, si Bashkia më e afërt gjeografikisht me Bashkinë Vau i Dejës ka të ngritura disa tipe shërbimesh të kujdesit shoqëror duke krijuar një eksperiencë dhe model praktik tek i cili struktura përgjegjëse e shërbimeve sociale të Bashkisë mund të mbështetet. Ndërkohë Bashki të tjera në vend, si Bashkia e Tiranës, që kanë një sistem të ngritur shërbimesh mund të jenë gjithashtu një burim dhe model që mund të ndiqet nga kjo Bashki. Vizita studimore mund të stafit të strukturës përgjegjëse pranë shërbimeve të ngritura do ti ndihmojnë në ngritjen e tyre në territorin e Bashkisë Vau i Dejës.

## Rreziqet

### *1. Kërkesa për shërbime e lartë*

Në kushtet e mungesës së shumicës dërmuese të shërbimeve të nevojshme, Plani do të përfshijë një shportë shërbimesh që duhet të ngrihet nga zero në një periudhë të shkurtër kohore. Ngritja e kësaj shporte shërbimesh do të kërkoj angazhim të strukturës përgjegjëse në dy drejtime kryesore: sigurimin e financimit dhe ngritjes së shërbimeve.

### *2. Hendek i financimit të Planit Social*

Bashkia nuk ka parashikuar në buxhetin tre vjeçar të saj fonde shtesë për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror. Bashkisë do ti duhet të alokoj fonde nga të ardhurat e saj, të kërkoj mbështetje financiare nga Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, sikurse të ndërtojë punën me donatorë të ndryshëm me qëllim financimin e komponentëve të këtij Plani. Strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki do ti duhet të identifikojë donatorë të mundshëm dhe të punojë ngushtë me specialistin e projekteve të Bashkisë me qëllim hartimin e projekteve të detajuara për të siguruar financim për zbatimin e Planit.

### *3. Mungesa e eksperiencës në ngritjen e shërbimeve të reja*

Strukturat e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashki duhet të familjarizohen me standartet e shërbimeve të kujdesit shoqëror të parashikuara për tu ngritur si pjesë e Planit Social, sikurse dhe me procedurat e ngritjes së shërbimeve (nëse shërbimi do ngrihet nga Bashkia) apo prokurimit të tyre (nëse shërbimi do financohet nga Fondi Social, por do të ngrihet nga operatorë jopublikë). Kjo sfidë që duhet kapërcyer përmes trainimeve, por edhe vizitave studimore në shërbime egzistuese jashtë Bashkisë Vau i Dejës.

## 3. QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Për të mundësuar përmbushjen e vizionit të saj Plani Social për periudhën tre vjeçare 2021-2023 parashikon masa në tre drejtime kryesore: (1) Formatimin në përputhje me ligjin të strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashki dhe Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit. Plotësimi me burimet njerëzore, ndryshimet në detyrat funksionale dhe ngritja e kapaciteteve të të gjithë ekipit në të dy nivelet është e domosdoshme në kushtet që çdo ndërhyrje e parashikuar në këtë Plan për ngritjen e shërbimeve dhe referimin e individëve në nevojë tek shërbimet do të mundësohet nga puna e këtyre strukturave. (2) Shporta e shërbimeve komunitare të kujdesit shoqëror të parashikuar në këtë Plan përfshin format më prioritare të shërbimeve të bazuar jo vetëm tek nevojat e identifikuara për shërbime në këtë Bashki, por edhe në kapacitetet e saj financiare për të përballuar ngritjen e shërbimeve si dhe thithjen e fondeve nga burime jashtë Bashkisë. (3) Garantimi i cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara është po aq i rëndësishëm sa edhe vetë shërbimet e ngritura, prandaj Plani parashikon masa konkrete për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve, sikurse dhe rishikimin periodik të Planit Social në konsultim me përfituesit e shërbimeve.



**Qëllimi 1:** **Bashkia Vau i Dejës do të ketë burimet njerëzore dhe kapacitetet e nevojshme për të adresuar cilësisht nevojat e grupeve vulnerabël**

**Objektivi 1: Brenda vitit 2021 strukturat e shërbimeve sociale në Bashki dhe njësi administrative do të kenë kapacitetet e nevojshme për të përmbushur cilësisht detyrimet ligjore**

***Aktiviteti 1.1: Riorganizimi i strukturës përgjegjëse të shërbimeve sociale në Bashki dhe ngritja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit***

Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale do të përmbush këto funksione:

1. Koordinimi dhe drejtimi i zbatimit të programeve të pagesave cash NE dhe PAK për të gjithë territorin e Bashkisë.
2. Ngritja dhe funksionimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivelin komunitar.
3. Mbrojtja dhe përkujdesja për fëmijët.
4. Barazia gjinore dhe masa kundër dhunës në familje.
5. Përfshirja e grupeve vulnërabël, fokus i veçantë për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara.
6. Strehimi social.

Për përmbushjen e këtyre funksioneve në përbërje të Drejtorisë do të jenë këto pozicione më përshkrimet vijuese të cilat do të përfshihen në Rregulloren e Bashkisë:

*1. Drejtori (1)* - Koordinon, drejton të gjithë aktivitetin e sektorit në të gjithë komponentët në përputhje me funksionet e sektorit dhe mundëson ndërveprimin institucional me institucionet lokale, organizatat joqeveritare dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në fushat që mbulon sektori.

*2. Specialist i mbrojtjes sociale dhe fuqizimit ekonomik (1):* Administron dhe monitoron ndihmën ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar të individëve dhe grupeve në nevojë për të gjithë territorin e Bashkisë. Ndërvepron me administratorët shoqëror të Njësive të Vlerësimit të nevojave dhe Referimit për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e satistikave të skemës së mbrojtjes sociale, si dhe mbështet me kapacitete administratorët shoqëror. Është përgjegjës për koordinimin dhe përmbushjen e komponentëve të Planit Social që lidhen me fuqizimin ekonomik të familjeve pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme. Përmbush funksionet e strehimit social duke përfshirë aplikimin për fonde pranë Ministrisë së linjës, aplikimet e familjeve/individëve që kanë të nevojshëm strehimin social dhe përgatitjen e projektvendimeve për Këshillin Bashkiak.

*3. Specialist i shërbimit social (1):* Drejton punën për identifikimin e nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin në juridiksionin e bashkisë. Hartimi i projekt Planit Social vendor duke kostuar shërbimet e nevojshme të identifikuara, si dhe përgatitjen e Programit Buxhetor vjetor përkatës, për miratim ne këshillin bashkiak; planifikimi i kalendarit të shpërndarjes vjetore dhe sigurimin e ofrimit të paketës bazë të shërbimeve të kujdesit shoqëror gjatë një viti. Krijimi i sistemit të mbikëqyrjes së shërbimeve në territorin e bashkisë. Propozimi i përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror për miratim nga Këshilli Bashkiak. Mbështet me kapacitete strukturat e menaxhimit të rastit në njësitë administrative. Përmbush detyra që rrjedhin nga ligji "Për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara".

*4. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës (1)* - Mbështet Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit për manaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje; Supervizon mirëqenien dhe përparimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në PMF të njësive administrative, të cilët kanë marrë Masat e Mbrojtjes dhe ndiqen me anë të një Plani Individual Mbrojtjeje; I raporton në mënyrë periodike Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve (ASHMDF), me të dhëna statistikore të procesuara mbi fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe NJMF përkatëse; Identifikon të gjithë aktorët dhe ofruesit e shërbimeve publike dhe jo publike për mbrojtjen e fëmijëve në territorin e bashkisë, përfshi përfaqësuesit e shërbimeve të përkujdesit alternativ, shërbimeve shëndetësore, psikologjike, sociale, ligjore, punonjësit e specializuar të policisë, përfaqësuesit e prokurorisë dhe institucionet arsimore; Mbledh Grupin Teknik Ndërsektorial në nivelin e bashkisë dhe koordinon funksionimin e tij, për identifikimin, analizën, mbrojtjen e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, referimin dhe ndjekjen në sistemin e drejtësisë të rasteve, lidhur me Masat e Mbrojtjes dhe Urdhrat e Mbrojtjes; Rrit ndërgjegjësimin e komunitetit mbi mbrojtjen e fëmijëve, organizon aktivitete informuese, edukuese dhe trajnuese mbi mbrojtjen e fëmijëve në territorin e bashkisë; Shërben si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë mund të informohen mbi apo të referohen tek shërbime apo institucione të tjera mbështetëse, sipas nevojave të tyre; Harton dhe rishikon në mënyrë të përvitshme listën e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktima dhe dëshmitarë në proceset penale, dhe ia dërgon strukturave vendore të policisë së shtetit, si dhe prokurorive dhe gjykatave përkatëse.

*5. Koordinatori për masa kundër dhunës në familje dhe punonjës për çështjet e barazisë gjinore (1)-* Përgatit Raporte periodike dhe informacione për Komitetin Drejtues Lokal. Koordinon Grupin Teknik Ndërsektorial dhe siguron burime ose i referon pranë shërbimeve. Siguron që të gjitha rastet e dhunës në familje të ndjekin të gjitha procedurat dhe siguron informacion gjithëpërfshirës dhe të përditësuar mbi situatën. Koordinon punën e të gjithë aktorëve dhe ofruesve të shërbimeve publike dhe jo publike për të garantuar nëpërmjet masave ligjore mbrojtje të anëtarëve të familjes që janë viktima të dhunës në familje, të

moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar. Është përgjegjës për integrimin e çështjeve të barazisë gjinore në politika, programe, dokumenta dhe ligje të cilat hartohen nga bashkia. Monitoron zbatimin e angazhimeve të qeverisjes vendore për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, në përputhje me dokumentat strategjike dhe ligjet kombëtare, si dhe në konventat ndërkombëtare.

Në varësi të Drejtorisë së mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale do të jenë Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit përbërja e të cilave përcaktohet nga numri i popullsisë dhe numri i fëmijëve në territorin e çdo njësie administrative. Përbërja e tyre jepet në tabelën në vijim, ndërkohë detyrat funksionale që specifikohen në këtë Plan do të përfshihen në Rregulloren e Bashkisë.

*Tabela 2: Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit*

| NJESIA ADMINISTRATIVE | TE DHENAT REFERENCE | | | | NJESIA E VLERESIMIT TE NEVOJAVE DHE REFERIMIT | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. Banorë | Nr. Fëmijë | Nr.familje NE | Nr. Individ PAK | Punonjës Social | PMF | Administrator shoqëror |
| Vau i Dejës | 15,749 | 4,317 | 272 | 277 | 1 | 1 | 2 |
| Temal | | | 149 | 61 | | | 1 |
| Bushat | 24,934 | 6,205 | 151 | 363 | 2 | 2 | 2 |
| Hajmel | 9,169 | 2,406 | 207 | 116 | 1 | | 1 |
| Vig Mnele | | | 120 | 39 | | | 1 |
| Shllak | 1,956 | 646 | 148 | 53 | | | 1 |
| **TOTALI** | **51,808** | **13,574** | **1,047** | **909** | **4** | **3** | **8** |

***Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit Vau i Dejës do të përbëhet nga:***

*Administratori shoqëror (2):* Administron, zbaton dhe monitoron ndihmën ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar të individëve dhe grupeve në nevojë; Identifikon dhe Referon individët dhe familjet në nevojë tek punonjësi social sipas nevojave; Propozon dhe kontribuon në përmirësimin e politikave, programeve, dokumentave dhe kornizës ligjore në mbështetje të individëve në nevojë dhe në përputhje me prioritetet kombëtare dhe lokale; Koordinon punën dhe ofron mbështetjen e nevojshme për të parandaluar varfërinë dhe

përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet në nevojë duke iu referuar një sistemi ndërhyrjesh dhe shërbimesh për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës; Përgatit, monitoron dhe bashkëpunon në mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave kombëtare në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore duke respektuar formatin e miratuar nga MMRS si autoriteti përgjegjës.

*Punonjësi social (1) :* kryen identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë; vlerësimin fillestar të nevojave dhe të nivelit të riskut për individët në nevojë; informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla; hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes; bashkërendimin e mbështetjes për individët dhe familjet në nevojë, dhe referimin tek shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal dhe qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm; përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit; mbikëqyrjen në vazhdim të ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimin mbi përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar; hedhjen e të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, në Regjistrin Elektronik Kombëtar.

*Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës (1):* Përgatit vlerësimin e rrezikut të fëmijëve në nevojë për mbrojtje; Perditeson bazën e të dhënave të mbrojtjes së fëmijëve me informacion mbi fëmijët në nevojë për mbrojtje, Masat e Mbrojtjes dhe Planin Individual të Mbrojtjes; Mbledh Grupin Teknik Ndërsektorial në nivelin e njësisë administrative dhe merr masa për zbatimin e vlerësimit të rastit të cdo fëmije në nevojë për mbrojtje dhe përgatitjen e një Plani Individual Mbrojtjeje, i cili përfshin propozimin për marrjen e Masave të Mbrojtjes; Informon NJMF dhe Drejtorin e strukturës përgjegjëse në bashki mbi Planin Individual të Mbrojtjes dhe propozimin për marrjen e Masave të Mbrojtjes dhe koordinon ndërhyrjet dhe veprimet e përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes; Monitoron zbatimin e Masës së mbrojtjes dhe përparimin e zhvillimit të fëmijës nën këtë masë mbrojtjeje; I kërkon anëtarëve të Grupit Teknik Ndërsektorial informacion mbi përparimin, sfidat dhe problemet e hasura gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes; Propozon ndryshimin apo heqjen e Masës së Mbrojtjes dhe/ose ndryshimin apo mbylljen e Planit Individual të Mbrojtjes, nëse kushtet për shkak të të cilave ishte marrë masa dhe ishte ndërtuar plani, nuk ekzisotjnë më, apo kur një propozim i tillë i shërben fëmijës dhe është në interesin e tij/e saj më të mirë; Lehtëson dhe mbështet fëmijën dhe/ose familjen e tij/saj në kryerjen e veprimeve apo detyrave të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes; Merr pjesë në procese gjyqësore ku diskutohen Masat e Mbrojtjes të propozuara në Planin Individual të Mbrojtjes për rastet e fëmijëve që ai/ajo po menaxhon; I kërkon prokurorit heqjen e përgjegjësisë prindërore, duke e informuar atë mbi prindërit që shfaqin mungesë të fortë përkujdesi në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.

***Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit Bushat do të përbëhet nga:***

*Administratori shoqëror (2):* Administron, zbaton dhe monitoron ndihmën ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar të individëve dhe grupeve në nevojë; Identifikon dhe Referon individët dhe familjet në nevojë tek punonjësi social sipas nevojave; Propozon dhe kontribuon në përmirësimin e politikave, programeve, dokumentave dhe kornizës ligjore në mbështetje të individëve në nevojë dhe në përputhje me prioritetet kombëtare dhe lokale; Koordinon punën dhe ofron mbështetjen e nevojshme për të parandaluar varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet në nevojë duke iu referuar një sistemi ndërhyrjesh dhe shërbimesh për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës; Përgatit, monitoron dhe bashkëpunon në mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave kombëtare në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore duke respektuar formatin e miratuar nga MMRS si autoriteti përgjegjës.

*Punonjësi social (2)* : kryen identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë; vlerësimin fillestar të nevojave dhe të nivelit të riskut për individët në nevojë; informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla; hartimin e planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes; bashkërendimin e mbështetjes për individët dhe familjet në nevojë, dhe referimin tek shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal dhe qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm; përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit; mbikëqyrjen në vazhdim të ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimin mbi përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar; hedhjen e të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, në Regjistrin Elektronik Kombëtar.

*Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës (2):* Përgatit vlerësimin e rrezikut të fëmijëve në nevojë për mbrojtje; Perditeson bazën e të dhënave të mbrojtjes së fëmijëve me informacion mbi fëmijët në nevojë për mbrojtje, Masat e Mbrojtjes dhe Planin Individual të Mbrojtjes; Mbledh Grupin Teknik Ndërsektorial në nivelin e njësisë administrative dhe merr masa për zbatimin e vlerësimit të rastit të cdo fëmije në nevojë për mbrojtje dhe përgatitjen e një Plani Individual Mbrojtjeje, i cili përfshin propozimin për marrjen e Masave të Mbrojtjes; Informon NJMF dhe Drejtorin e strukturës përgjegjëse në bashki mbi Planin Individual të Mbrojtjes dhe propozimin për marrjen e Masave të Mbrojtjes dhe koordinon ndërhyrjet dhe veprimet e përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes; Monitoron zbatimin e Masës së mbrojtjes dhe përparimin e zhvillimit të fëmijës nën këtë masë mbrojtjeje; I kërkon anëtarëve të Grupit Teknik Ndërsektorial informacion mbi përparimin, sfidat dhe problemet e hasura gjatë zbatimit të masave të mbrojtjes; Propozon ndryshimin apo heqjen e Masës së Mbrojtjes dhe/ose ndryshimin apo mbylljen e Planit Individual të Mbrojtjes, nëse kushtet për shkak të të

cilave ishte marrë masa dhe ishte ndërtuar plani, nuk ekzisotjnë më, apo kur një propozim i tillë i shërben fëmijës dhe është në interesin e tij/e saj më të mirë; Lehtëson dhe mbështet fëmijën dhe/ose familjen e tij/saj në kryerjen e veprimeve apo detyrave të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes; Merr pjesë në procese gjyqësore ku diskutohen Masat e Mbrojtjes të propozuara në Planin Individual të Mbrojtjes për rastet e fëmijëve që ai/ajo po menaxhon; I kërkon prokurorit heqjen e përgjegjësisë prindërore, duke e informuar atë mbi prindërit që shfaqin mungesë të fortë përkujdesi në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.

***Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit Hajmel do të përbëhet nga:***

*Punonjësi social (1):* Ndërton rrjetin institucional lokal për menaxhimin e rasteve të individëve në nevojë për shërbime; Drejton punën për identifikimin proaktiv të rasteve në territorin e njësisë administrative; bashkëpunon me PMF dhe koordinatorin vendor për masa kundër dhunës në familje gjatë menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje apo viktimave të dhunës në familje; Informon dhe këshillon për marrjen e shërbimeve çdo individ që ka nevojë për to; Menaxhon rastet sociale, përgatit dokumentacionin për referim në marrje shërbimi dhe mbikqyr zbatim ne planit individual të mbrojtjes për çdo individ që ka të nevojshëm shërbime të kujdesit shoqëror;

*Administratori shoqëror (1):* Administron, zbaton dhe monitoron ndihmën ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar të individëve dhe grupeve në nevojë; Identifikon dhe Referon individët dhe familjet në nevojë tek punonjësi social sipas nevojave; Koordinon punën dhe ofron mbështetjen e nevojshme për të parandaluar varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet në nevojë duke iu referuar një sistemi ndërhyrjesh dhe shërbimesh për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës; Përgatit, monitoron dhe bashkëpunon në mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore duke respektuar formatin e miratuar nga Ministria përgjegjëse për çështjet sociale. Ndërvepron me punonjësin social ose punonjësin e mbrojtjes së fëmijës ose koordinatorin vendor për masa kundër dhunës në familje (sipas fushës së përgjegjësisë së secilit dhe rastit në menaxhim) për identifikimin e rasteve dhe menaxhimin e tyre.

***Secila nga Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit Temal, Vig Mnellë dhe Shllak do të përbëhet nga:***

*Administratori shoqëror (1):* Administron, zbaton dhe monitoron ndihmën ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar të individëve dhe grupeve në nevojë; Identifikon dhe Referon individët dhe familjet në nevojë tek punonjësi social në Bashki sipas nevojave; Koordinon punën dhe ofron mbështetjen e nevojshme për të parandaluar varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet në nevojë duke iu referuar një sistemi ndërhyrjesh dhe shërbimesh për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës; Përgatit, monitoron dhe bashkëpunon në mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave në fushën e ndihmës

dhe shërbimeve shoqërore duke respektuar formatin e miratuar nga Ministria përgjegjëse për çështjet sociale. Ndërvepron me punonjësin social ose punonjësin e mbrojtjes së fëmijës ose koordinatorin vendor për masa kundër dhunës në familje (sipas fushës së përgjegjësisë së secilit dhe rastit në menaxhim) në Bashki për identifikimin e rasteve dhe menaxhimin e tyre.

***Aktiviteti 1.2 Mbështetja me kapacitete e stafit të strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale të Bashkisë***

Në kushtet që stafi do të ketë detyra të reja funksionale është e rëndësishme që për ta të ndërmerren trainime të vazhdueshme me qëllim përmbushjen cilësore të detyrave funksionale që kanë. Në përputhje edhe me nevojat e identifikuara për trainim ky staf në periudhën tre vjeçare të zbatimit të këtij Plani do të trainohet në mënyrë të veçantë mbi: (i) standartet e shërbimeve të kujdesit shoqëror; (ii) procedurat për ngritjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror; (iii) mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së shërbimeve të qendrave të përkujdesit; (iv) prokurimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ndërkohë punonjësi i mbrojtes së fëmijës dhe koordinatori për masa kundër dhunës në familje do të përfshihen në trainime specifike sipas fushës së përgjegjësisë, së bashku me përfaqësuesit e institucioneve pjesë e mekanizmave përkatës dhe stafet e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.

***Aktiviteti 1.3 Mbështetja me kapacitete e stafeve të Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit***

Këto njësi janë baza nga ku fillon marrja e shërbimeve të kujdesit shoqëror nga individët në nevojë për këto shërbime. Njësitë janë përgjegjëse për identifikimin e rasteve të individëve në nevojë për shërbime, për informimin dhe këshillimin e çdo individi mbi shërbimet, menaxhimin e rasteve dhe referimin e tyre tek shërbimet e vlerësuara sipas nevojës. Në kushtet që ato do të funksionojnë sipas një modeli tërësisht të ri, është i rëndësishëm trainimi i gjithë personelit të këtyre njësive. Trainimet që do të ndërmerren për ta në periudhën tre vjeçare të zbatimit të Planit do të fokusohen kryesisht në këto çështje: (i) Paketa legjislative mbi shërbimet e kujdesit shoqëror dhe fusha specifike që lidhen me të; (ii) Menaxhim rasti për stafet në njësitë administrative dhe përfaqësuesit e institucioneve lokale në grupet teknike ndërsektoriale; (iii) Trainime për aksesin e personave me aftësi të kufizuara dhe vlerësimin biopsikosocial; (iv) Trainime për barazinë gjinore dhe dhunën në familje. (v) Trainime mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

## Objektivi 2: Rritja e rasteve të identifikuara dhe mbështetura me shërbime të mbrojtjes e përkujdesit social

### *Aktiviteti 2.1 Ngritja e sistemit të referimit të rasteve sociale*

Struktura përgjegjëse e Bashkisë duhet të ndërtoj brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit të parë të zbatimit të Planit sistemin e referimit të rasteve sociale. Ky sistem duhet ti japë përgjigje pyetjes: ku do të referohen rastet e identifikuara në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje? Përveç vendosjes së një numri telefoni unik që do të jetë pa pagesë dhe që do të marri thirrjet për rastet sociale, struktura përgjegjëse do të përcaktojë se si do të reagohet pas marrjes së çdo telefonate për të vënë në lëvizje mekanizmin që do të menaxhoj rastin e raportuar në nevojë. Ky sistem i ngritur i bëhet me dije të gjitha ekipeve të Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit. Struktura përgjegjëse publikon këtë sistem referimi në ambjentet e çdo njësie administrative, të zyrave të Bashkisë që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me banorët, si dhe në faqen elektronike në internet të Bashkisë.

### *Aktiviteti 2.2 Takime informuese me institucione lokale që ofrojnë shërbime/janë në kontakt të drejtpërdrejtë me komunitetin*

Qendrat shëndetësore, policia, shkollat, kryetarët e fshatrave, ndërlidhësit e komunitetit, gjendja civile, zyra e tatim-taksave, organizatat që ofrojnë shërbime në territor apo që punojnë për përmbushjen e të drejtave të njeriut janë në kontakt të drejtpërdrejtë me komunitetin dhe mund të identifikojnë raste të individëve që kanë nevojë për shërbime kujdesi shoqëror. Për këtë arsye është e rëndësishme që personeli i tyre të dijë se ku duhet ti referojnë këto raste, sikurse edhe çfarë rolesh e përgjegjësish kanë strukturat e Bashkisë në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Në gjashtëmujorin e parë të zbatimit të Planit Social struktura përgjegjëse në bashkëpunim me Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të njësive administrative realizon 6 tryeza informuese me përfaqësues të institucioneve, organizatave të sipërcituara, sipas njësisë administrative ku ato punojnë. Në secilën prej tryezave prezantohet: (i) rolet dhe përgjegjësitë e Bashkisë në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror; (ii) mekanizmi i referimit të rasteve; si dhe diskutohen rrugët e ndërveprimit mes institucioneve dhe organizatave me qëllim identifikimin e vazhdueshëm të rasteve të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.

### *Aktiviteti 2.3 Informimi i drejtpërdrejtë i komuniteteve*

Nga vlerësimi i nevojave rezultoi se është i nevojshëm (i) ndërgjegjësimi i komunitetit mbi çështjet e të drejtave të fëmijëve, në të gjithë territorin por veçanërisht në njësitë administrative Shllak dhe Temal; (ii) përfshirja e komunitetit në luftën kundër dhunës në familje në të gjithë territorin, por në mënyrë të veçantë në njësitë administrative Hajmel, Vig Mnellë dhe Shllak. Ndërkohë, bashkë me ngritjen e shërbimeve komuniteti duhet të jetë i informuar mbi egzistencën e tyre si dhe mënyrën se si mund ti aksesoj ato. Për këtë arsye struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në Bashki do të përgatisë përmbajtjen e takimeve informuese dhe Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit do të realizojnë këto takime në çdo fshat pjesë e territorit të tyre. Çështjet ku do të fokusohet çdo takim: (i) ku dhe si të kërkojnë mbështetje për ndihmë ekonomike, aftësinë e kufizuar dhe shërbime të kujdesit shoqëror; (ii) mbrojtja e fëmijëve, tema specifike për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, mbrojtjen nga dhuna apo çështje të tjera të identifikuara nga Njësia e Mbrojtjes së fëmijës në periudhën që zbatohet Plani Social; (iii) parandalimi i dhunës në familje dhe shërbimet që ndihmojnë riintegrimin e viktimave të saj.

*Tabela 3: Takime informuese në komunitet*

| Njësia administrative | Numri i takimeve | Përgjegjës për zbatimin |
|---|---|---|
| Vau i Dejës | 9 (Vau i Dejës dhe 8 fshatra) | *Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit Vau i Dejës* |
| Bushat | 14 (Bushat dhe 13 fshatra) | *Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit Bushat* |
| Temal | 10 (fshatra) | *Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit Temal, si dhe NJMF dhe koordinatori vendor për dhunën* |
| Hajmel | 5 (fshatra) | *Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit Hajmel* |
| Vig Mnellë | 3 (fshatra) | *Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit Vig Mnellë, si dhe NJMF dhe koordinatori vendor për dhunën* |
| Shllak | 7 (fshatra) | *Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit Shllak, si dhe NJMF dhe koordinatori vendor për dhunën* |

### *Aktiviteti 2.4 Menaxhim efektiv i rasteve sociale*

Çdo rast i individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje do të menaxhohet nga Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit sipas vendbanimit që ka individi. Në njësitë Vau i Dejës, Bushat dhe Hajmel që kanë ekipe miks punonjës social, administrator shoqëror dhe Punonjës së mbrojtjes së fëmijës stafet ndërveprojnë me njëri tjetrin. Çdo familje që aplikon apo riaplikon për ndihmë ekonomike referohet nga administratori shoqëror tek punonjësi social si dhe PMF (kur familja ka fëmijë) për të vlerësuar nevojat e familjes dhe ndërtuar një plan për nxjerrjen nga varfëria. Në njësitë administrative Vig Mnellë, Temal dhe Shllak që kanë vetëm administratorin shoqëror, ky i fundit është përgjegjës për menaxhimin e çdo rasti, por në rastin e fëmijëve dhe të dhunës në familje duke ndërvepruar me NJMF dhe koordinatorin për masa kundër dhunës në familje pjesë e strukturës përgjegjëse të Bashkisë. Çdo njësi administrative përballon kostot që rrjedhin nga menaxhimi i rasteve të tilla si: kosto transporti për vlerësime në familje, kosto të dokumentacionit për raste specifike etj. Në përputhje me vlerësimet e kryera për çdo rast NjVNR do të vendosë në konsultim me vetë individin në nevojë për tipin/et e shërbimit ku do të referohet, do të përgatisë dokumentacionin specifik dhe do të përcjellë pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki dokumentacionin dhe kërkesën për marrjen e shërbimit. Kjo e fundit pas vlerësimit (sipas rastit) në komisionin multidisiplinar ndjek procedurat e miratimit të marrjes së shërbimit dhe më pas përfshirjen e individit në shërbimin specifik.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

United Nations ALBANIA

unicef for every child

**NDËRVEPRIMI I STRUKTURAVE TË MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE KUJDESIT SOCIAL TË BASHKISË**



## *Qëllimi 2: Rintegrim ekonomik për familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme*

### Objektivi 1: Krijimi i hapësirave për punësim dhe riintegrim ekonomik për të paktën 20% të punëkërkuesve

#### *Aktiviteti 1.1 Këshillim dhe ndërmjetësim për punësim*

Tre nga problematikat që dolën në pah në lidhje me punësimin do të adresohen përmes këtij aktiviteti: (1) distanca e madhe mes Zyrës së Punës dhe individëve në moshë ëpr punë nga familje ëprfituese të ndihmës ekonomike; (2) mos pranimi i ofertave të punës nga një pjesë e punëkërkuesve dhe (3) numri shumë i ulët i punëkrkuesve me aftësi të kufizuara të rregjistruar ën Zyrën e Punës.

Përmes një Marrëveshje mes Zyrës së Punës dhe Bashkisë Vau i Dejës do të mundësohet ofrimi i këshillimit dhe ndërmjetësimit për punësim pranë njësive administrative të kësaj Bashkie. Një specialist i Zyrës së Punës bashkë me administratorin shoqëror të njësisë administrative përkatëse do të zhvillojnë dy herë në vit takime individuale me punëkërkuesit nga familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike, si dhe me persona me aftësi të kufizuara që nuk kanë diagnoza të rënda. Bashkë me ofertat për punë apo kurset e formimit profesional, takimet do ti shërbejnë edhe ndërgjegjësimit mbi domosdoshmërinë e përfshirjes në tregun e punës.

Specialisti i mbrojtjes sociale dhe fuqizimit ekonomik, pjesë e Drejtorisë së mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale, do të ndërveprojë me sektorin e tatim taksave të Bashkisë për të identifikuar e listuar bizneset në territorin e Bashkisë që kanë kapacitete për punësim. Bashkia do të ftojë në një tryezë përfaqësues të këtyre bizneseve për të diskutuar mbi hapësirat për të nxitur punësimin e pjesëtarëve në moshë pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Çdo vend pune që krijohet nga bizneset apo nga Bashkia Vau i Dejës do të publikohet pranë çdo njësie administrative dhe specialisti i mbrojtjes sociale dhe fuqizimit ekonomik do të ndërveprojë me administratorët shoqëror me qëllim nxitjen e individëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike për të pranuar ofertat e punës.

#### *Aktiviteti 1.2 Financim i projekteve për nxitje biznesei*

Bashkia do të financojë çdo vit 10 projekte për ngritje biznesi. Çdo projekt që do të mbështetet do të ketë buxhet deri në 500 mijë lekë. Përfitues të kësaj mbështetje për ngritje biznesi do të jenë gratë, viktimat e dhunës në familje, persona me aftësi të kufizuar, si dhe të rinjtë deri në moshën 35 vjeçare. Përgjatë vitit të parë Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe

përfshirjes sociale do të përgatis infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e këtij programi, specifikisht: në gjashtëmujorin e dytë të vitit të parë do të përgatis manualet për procedurat operacionale. Në gjashtë mujorin e parë të vitit të dytë do të hapet thirrja për aplikime dhe do të vlerësohen aplikimet. Për të lehtësuar këtë proces specialisti i mbrojtjes sociale dhe fuqizimit ekonomik do të kryejë një vizitë studimore në një nga Bashkitë që ka zhvilluar një program të tillë.

***Aktiviteti 1.3 Ngritje e bizneseve sociale***

Bashkia Vau i Dejës do të shfrytëzojë hapësirat që krijon ligji "Për ndërmarrjet sociale", si dhe eksperiencat aktuale të organizatave joqeveritare që kanë zhvilluar projekte të ngjashme në territorin e saj, për të mundësuar të tjera forma financimi të bizneseve që punësojnë pjesëtarë të familjeve pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme, persona me aftësi të kufizuara apo individë të rrezikuar nga varfëria. Specialisti i mbrojtjes sociale dhe fuqizimit ekonomik do të punojë për të zgjeruar partneritetin jo vetëm me dy organizatat që punojnë për fuqizimin ekonomik të grave në territorin e Bashkisë, por edhe me organizata të tjera të cilat në përputhje me ligjin "Për ndërmarrjet sociale" mund të rregjistrohen pranë Ministrisë së Linjës dhe të aplikojnë më pas pranë saj për fonde për ngritjen e bizneseve sociale. Bashkia do të lehtësojë për organizatat të kuptuarin e situatës reale të grupeve në nevojë, si dhe të karakteristikave të tregut të punës, në mënyrë që ato të targetojnë në projektet e tyre grupet e duhura dhe të parashikojnë biznese që janë të qëndrueshme në kohë.

***Qëllimi 3: Ngritja e shërbimeve të kujdesit shoqëror që adresojnë nevojat e grupeve dhe individëve në nevojë për këto shërbime***

**Objektivi 1. Brenda vitit 2023 nevojat për shërbime të emergjencës, reabilituese, zhvilluese dhe riintegruese të grupeve në nevojë do të adresohen përmes sistemit komunitar funksional të shërbimeve të kujdesit shoqëror**

***Aktiviteti 1.1 Shërbime për fëmijët dhe familjen***

Në territorin e njësisë administrative Vau i Dejës do të ngrihet Qendra Multifunksionale për Fëmijën dhe Familjen. Qendra do të përfshijë tipe të ndryshme shërbimesh që në thelb përmbushin nevojat e këtyre grupeve: familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje, viktimave të dhunës në familje, pjesëtarëve të familjeve që kanë përjetuar divorc, përdoruesve të alkoolit.

Shërbimet do të ofrohen nga ekip profesionistësh dhe do të dizenjohen në përputhje me standartin kombëtar për këtë formë shërbimi.

Qendra do të ofrojë këto shërbime:

1. Shërbim ditor për fëmijë i cili do të mundësojë shërbim psikologjik, edukimi, kohës së lirë, emergjence. Fëmijët e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike apo viktimave të dhunës në familje do të përfshihen në qendrën ditore dhe do të mbështeten për përgatitjen e mësimeve, kalimin në mënyrë kreative të kohës së lirë etj. Shërbimi psikologjik dhe ai i emergjencës do të mundësojnë mbështetjen e fëmijëve që nuk banojnë në territorin e njësisë administrative Vau i Dejës, por që kanë të nevojshme këto forma shërbimi sipas vlerësimit të kryer nga NJMF.

2. Këshillime ligjore falas, këshillim për prindërimin, këshillim për punësimin. Stafi i qendrës do të ndërveprojë me shërbimet e punësimit, formimit professional, strehimit etj për të nxitur fuqizimin ekonomik të familjeve të këtyre fëmijëve.

3. Shërbim psikologjik do të mundësojë terapi jo vetëm për fëmijët, por edhe për prindërit, viktimat e dhunës në familje, përdorues të alkoolit, familje që kanë përjetuar divorc. Në qendër do të organizohen gjithashtu kurse prindërimi. Këto të fundit jo vetëm për prindërit, por edhe për prindër të mundshëm kujdestarë duke hedhur kështu bazat për ngritjen e shërbimit të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror.

4. Shërbim emergjence për individë dhe familje esktremisht të varfëra. Qendra do të menaxhojë rastet e emergjencave duke ofruar pako ushqimore dhe pako higjenike sipas vlerësimeve të kryera nga NJVNR. Të paktën 100 raste në vit priten të menaxhohen nga qendra në të gjithë territorin e Bashkisë.

### *Aktiviteti 1.2 Aksesueshmëria dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara*

Kjo masë adreson një nga mungesat e identifikuara në Bashkinë Vau i Dejës: mungesën e Planit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara. Ky Plan në thelb do të mundësojë analizën e thelluar multisektoriale të nevojave të personave me aftësi të kufizuara në këtë Bashki, duke parashikuar njëkohësisht edhe masat që duhet të marrin jo vetëm njësitë specifike të Bashkisë, por edhe institucione të tjera si arsimi, shëndetësia, zyra e punës, formimi profesional etj për të përmbushur kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Si pjesë e këtij Plani Bashkia do të parashikojë një plan masash për realizimin e aksesueshmërisë në komunikim e infrastrukturë për të gjitha grupet e aftësisë së kufizuar (vështirësi në lëvizje, persona të verbër, persona që nuk komunikojnë, persona me aftësi të kufizuara intelektuale). Në këtë Plan Bashkia do të evidentojë objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve për të cilat nevojitet

përshtatshmëria, të planifikojë fondet dhe afatin kohor se kur do të mundësojë përshtatshmërinë.

### *Aktivteti 1.3 Shërbime reabilituese, fuqizuese, riintegruese për personat me aftësi të kufizuara*

Në territorin e njësisë administrative Bushat do të ngrihet dhe do të funksionojë Qendra Ditore Multifunksionale për Personat me Aftësi të Kufizuara. Arsyeja e ngritjes në këtë njësi lidhet sa me numrin më të lartë të personave me aftësi të kufizuara që banojnë në këtë njësi krahasuar më njësitë e tjera, ashtu edhe me mundësitë që ka Bashkia për infrastrukturën e shërbimit në këtë njësi. Shërbimi lëvizës do të lehtësojë aksesin në qendër apo në shërbimet e saj edhe të personave me aftësi të kufizuara nga njësitë e tjera administrative.

Qendra do të ofrojë tipe të ndryshme shërbimesh sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Shërbimet do të ofrohen nga një ekip profesionistësh (kryesisht fizioterapist, logopedist, psikolog dhe okupacionist), në përputhje me standartet kombëtare për këtë tip shërbimi kujdesi shoqëror.

Për fëmijët me aftësi të kufizuar kryesisht intelektuale qendra do të ofroj shërbim ditor ose terapi individuale në përputhje me nevojat e vlerësuara të çdo fëmije. Për personat me aftësi të kufizuara që kanë përfunduar ciklin arsimor qendra do të ofrojë terapi fizike dhe okupacionale për disa orë në ditë.

Përveç shërbimit të drejtpërdrejtë të personave me aftësi të kufizuara ekipi i profesionistëve do të këshillojë, orientojë, trainojë edhe prindërit/familajrët/ndihmësit e personave me aftësi të kufizuara për të përmirësuar cilësinë e shërbimit dhe jetesës së personave me aftësi të kufizuara në mjedisin familjar dhe në komunitet.

Shërbim i lëvizshëm: Qendra do të shërbejë si pikë identifikuese dhe vlerësuese e nevojave të personave me aftësi të kufizuar. Në mënyrë të veçantë do të synohet ndërhyrja e herëshme për fëmijët parashkollorë që janë në rrezik për të zhvilluar aftësi të kufizuar apo kanë lindur me aftësi të kufizuar fizike, mendore, shqisore etj. Fëmijës do ti ofrohet ndërhyrje terapeutike multidisiplinare sipas nevojave te veçanta që paraqet (terapist të foluri, fizik, okupacional, etj.) ne mjedisin ku fëmija ushtron aktivitetin e përditshëm (në kopësht, shkollë apo qendrën ditore). Ndërveprimi me sistemin arsimor lokal do të jetë prioritet për të mundësuar këtë formë shërbimi. Për personat me aftësi të kufizuara që banojnë në zona larg qendrës multifunksionale por që kanë të nevojshëm shërbimet do të ofrohen shërbime në familje. Qendra do të ketë një mjet transporti të përshtatur.

Qendra do të shërbej gjithashtu edhe për informimin, orientimin dhe këshillimin e personave me aftësi të kufizuara, si dhe advokacie për të drejtat e tyre. Kjo formë shërbimi do të ofrohet

nga vetë personat me aftësi të kufizuara të trainuar dhe të punësuar pranë saj. Qëllimi është që personat me aftësi të kufizuar të mbështeten dhe të arrijne potencialin e tyre maksimal në gjirin e familjes dhe komunitetit. Qendra përmes informimit, orientimit, ndërmjetësimit do të lehtësojë aksesin e personave me aftësi të kufizuara tek shërbime të tjera të nevojshme si: strehimi, punesimi, transporti, aktivitete shlodhese, akses në sherbimet sociale e shëndetësore.

### *Aktivteti 1.4 Shërbime reabilituese dhe rintegruese për viktimat e dhunës në familje*

Shërbimi i strehimit të mbrojtur për viktimat e dhunës në familje do tu ofrohet viktimave të dhunës në familje që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situate që u kërcënon jetën dhe shëndetin. Në këto raste viktimave të dhunës do tu sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur. Dy ambjente emergjence do të shfrytëzohen për viktimat e dhunës në familje të cilat përvec sa më lart, do të përfitojnë edhe shërbim ligjor dhe psikologjik, si dhe paketa ushqimore dhe higjenike, si pjesë e shërbimit të Qendrës Multifunksionale për fëmijën dhe familjen.

Bashkia do të vijojë bashkëpunimin me dy qendrat jo publike që ofrojnë shërbimin e këshillimit dhe të emergjencës për viktimat e dhunës në familje, sikurse dhe të reabilitimit të dhunuesit.

Në programin e fuqizimit ekonomik pjesë e këtij Plani Social viktimat e dhunës në familje do të përfshihen me prioritet.

### *Aktiviteti 1.5 Shërbime për të moshuarit*

Qendra rezidenciale egzistuese do të plotësojë shërbimin aktual në përputhje me standartin kombëtar të shërbimit për qendrat ditore për të moshuarit dhe shërbimin në familje për të moshuarit. Qendra ditore do të ofrojë për të paktën 20 të moshuar mbështetje psikologjike, kujdes shëndetësor, aktivitete të kohës së lirë, përfshirje në komunitet dhe ushqim. Shërbimi në familje do të përmbush nevojat e të moshuarve që jetojnë në vështirësi ekonomike dhe në zonat jashtë njësisë administrative Vau i Dejës.

### *Aktiviteti 1.6 Trajtimi me bonus qeraje i familjeve të pastreha dhe në situatë të vështirë ekonomike*

Për familjet që e kanë të pamundur të sigurojnë strehimin dhe që janë në vështirësi ekonomike Bashkia do të mundësojë bonusin e qerasë duke prioritizuar: familjet me fëmijë, persona me aftësi të kufizuara, gratë kryefamiljare, viktima të dhunës në familje, të moshuarit.

## *Qëllimi 4: Sistemi komunitar i shërbimeve të kujdesit shoqëror përmbush standartet kombëtare të cilësisë dhe përshtatshmërisë*

### Objektivi 1: Sistemi komunitar i shërbimeve i përgjigjet cilësisht nevojave në ndryshim të grupeve vulnerabël

#### *Aktiviteti 1.1 Monitorimi i cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve*

Çdo shërbim që do të ngrihet dhe funkionojë në territorin e Bashkisë me fondet e saj do të monitorohet nga Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale. Me mbështetjen e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Shkodër punonjësi social i kësaj drejtorie do të zhvillojë instrumentat e monitorimit të çdo shërbimi bazuar në standartet kombëtare të shërbimit specifik. Pjesë e procesit të monitorimit do të jenë edhe intervistat/fokus grupet që do të zhvillohen me përfituesit e shërbimeve. Konkluzionet e çdo monitorimi do të lehtësojnë përmirësimin e cilësisë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve që ofrohen.

#### *Aktiviteti 1.2 Rishikimi periodik i Planit Social*

Edhe pse Plani i hartuar është tre vjeçar, për shkak të gjendjes në ndryshim të grupeve vulnerabël, por edhe aftësisë së Bashkisë për të thithur fonde e mundësuar financimin e komponentëve të Planit që janë parashikuar të zbatohen me financim jashtë Bashkisë, është i nevojshëm rishikimi i tij çdo vit. Për të mundësuar rishikimin e Planit Social drejtoria e mbrojtjes, përfshirjes dhe kujdesit social do të mbledhë dhe analizojë në mënyrë periodike treguesit socialë satistikorë dhe administrativë, si dhe të dhënat mbi shërbimet egzistuese. Përveç analizës së treguesve sociale kjo drejtori do të zhvillojë dëgjesa me grupet që preken nga zbatimi i Planit dhe në mënyrë të veçantë me: fëmijët, viktimat e dhunës në familje, përfaqësues të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit. Dëgjesat do ti shërbejnë identifikimit të nevojave për shërbime në këndvështrimin e vetë atyre që i kanë të nevojshme ato. Takime konsultuese do të zhvillohen dhe me institucionet që janë të përfshira në grupet teknike ndërsektoriale për të vlerësuar mundësinë e përmirësimeve të mëtejshme në punën për grupet vulnerabël në territorin e Bashkisë.

## 4. PLANI I VEPRIMIT

***Qëllimi 1 – Bashkia Vau i Dejës do të ketë burimet njerëzore dhe kapacitetet e nevojshme për të adresuar cilësisht nevojat e grupeve vulnerabël***

| AKTIVITETET | AKTORËT PËRGJEGJËS | AFATI | TREGUESIT | BURIMI I TË DHËNAVE | BURIMI I FINANCIMIT | KOSTO | MONITORIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 1. Brenda vitit 2021 strukturat e shërbimeve sociale në Bashki dhe njësi administrative do të kenë kapacitetet e nevojshme për të përmbushur cilësisht detyrimet ligjore** | | | | | | | |
| **Aktiviteti 1.1:**<br>***Riorganizimi i strukturës përgjegjëse të shërbimeve sociale në Bashki dhe ngritja e Njësive*** | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale<br>Drejtoria e burimeve njerëzore | Dhjetor 2020 | Struktura përgjegjëse, si dhe Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të organizuara në numër dhe funksione sipas | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"<br>Ligji "Për vetëqeverisjen | Bashkia | 7,641,300 | Sekretari i Përgjithshëm |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit*** | | | parashikimeve ligjore;<br><br>Rregullorja e Bashkisë përmban përshkrim të ri pune për strukturën përgjegjëse dhe çdo specialisti;<br><br>Rregullorja e Bashkisë përmban përshkrim të ri pune për Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe çdo specialist sipas parashikimeve ligjore; | vendore<br><br>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<br><br>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare"<br><br>Ligji "Për asistencën sociale" | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktiviteti 1.2:**<br><br>***Mbështetja me kapacitete e stafit të strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale të Bashkisë*** | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale<br><br>Partneritet me Drejtorinë Rajonale të SHSSH Shkodër | 2021<br>2022<br>2023 | Numri i trainimeve të zhvilluara në përputhje me fushat e identifikuara për ngritje kapacitetesh;<br><br>Numri i pjesëmarrësve në trainim në përputhje me rolin dhe funksionin që kanë;<br><br>Praktika pune të përmirësuara në vijim të trainimeve si rezultat i kapaciteteve të rritura dhe | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"<br><br>Ligji "Për vetqeverisjen vendore<br><br>Ligji "Për të drejtën e informimit publik"<br><br>Ligji "Për prokurimin Publik" | Bashkia<br><br>Partneritet me SHSSH dhe organizata joqeveritare | 1,280,000 | Sekretari i Përgjithshëm |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | shprehive të fituara nga trainimet; | | | | |
| **Aktiviteti 1. 3**<br><br>***Mbështetja me kapacitete e stafeve të Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit*** | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale<br><br>Partneritet me Drejtorinë Rajonale të SHSSH Shkodër | 2021<br><br>2022<br><br>2023 | Numri i trainimeve të zhvilluara në përputhje me fushat e identifikuara për ngritje kapacitetesh;<br><br>Numri i pjesëmarrësve në trainim në përputhje me rolin dhe funksionin që kanë;<br><br>Praktika pune të përmirësuara në vijim të trainimeve si | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"<br><br>Ligji "Për vetqeverisjen vendore<br><br>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<br><br>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien | Bashkia Partneritet me SHSSH dhe organizata joqeveritare | | Sekretari i Përgjithshëm |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | rezultat i kapaciteteve të rritura dhe shprehive të fituara nga trainimet; | familjare"<br><br>Ligji "për asistencën sociale"<br><br>Ligji "Për të drejtën e informimit publik" | | | |

*Qëllimi 1 – Bashkia Vau i Dejës do të ketë burimet njerëzore dhe kapacitetet e nevojshme për të adresuar cilësisht nevojat e grupeve vulnerabël*

| AKTIVITETET | AKTORËT PËRGJEGJËS | AFATI | TREGUESIT | BURIMI I TË DHËNAVE | BURIMI I FINANCIMIT | KOSTO | MONITORIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 2: Rritja e rasteve të identifikuara dhe mbështetura me shërbime të mbrojtjes e përkujdesit social** | | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktiviteti 2. 1**<br><br>***Ngritja e sistemit të referimit të rasteve sociale*** | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale | Janar 2021 | Numri publik ku do të referohen rastet i përcaktuar;<br><br>Skema se ku dhe si do të referohen rastet sociale e hartuar dhe e publikuar në mjediset publike të Bashkisë dhe pranë Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit<br><br>Sistemi i referimit i publikuar në faqen elektronike të Bashkisë; | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"<br><br>Ligji "Për vetqeverisjen vendore"<br><br>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<br><br>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare"<br><br>Ligji "Për të drejtën e informimit publik" | Bashkia | 170,500 | Sekretari i Përgjithshëm |
| **Aktiviteti 2.2**<br><br>***Takime informuese me*** | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe | Shkurt-Mars | Pjesëmarrësit dhe institucionet që përfaqësojnë në | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e | Bashkia | 0 | Sekretari i Përgjithshëm |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***institucione lokale që ofrojnë shërbime/janë në kontakt të drejtpërdrejtë me komunitetin*** | përfshirjes sociale | 2021 | secilin nga 6 takimet e zhvilluara janë në përputhje me objektivin e takimit;<br><br>Pjesëmarrësit dhe institucionet që përfaqësojnë kanë qartësi të plotë mbi sistemin e referimit dhe detyrat e tyre si pjesë e tij;<br><br>Praktika pune të përmirësuara në këndvështrimin e ndërveprimit mes institucioneve;<br><br>Numri i rasteve në nevojë për shërbime | Shqipërisë"<br><br>Ligji "Për vetqeverisjen vendore<br><br>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<br><br>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | shoqërore të identifikuara dhe të referuara në vijim nga institucionet e përfshira në këtë sistem; | | | | |
| **Aktiviteti 2. 3**<br><br>***Informimi i drejtpërdrejtë i komuniteteve***<br><br>***(48 takime në komunitet)*** | Punonjësi social<br><br>Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës<br><br>Koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje<br><br>Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit Vau i Dejës, Bushat, Temal, Hajmel, | 2021<br><br>2022<br><br>2023 | Numri i takimeve të zhvilluara;<br><br>Numri i individëve të informuar në sajë të takimeve të zhvilluara;<br><br>Çështjet e diskutuara e të prezantuara në çdo takim janë në përputhje me prioritetet e përcaktuara në | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"<br><br>Ligji "Për vetqeverisjen vendore<br><br>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<br><br>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" | Bashkia | 902,400 | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Vig Mnellë, Shllak | | Planin Social;<br><br>Rritje e numrit të individëve që janë referuar pranë sistemit të referimit për të marrë shërbime të kujdesit shoqëror; | | | | |
| **Aktiviteti 2.4**<br><br>***Menaxhim efektiv i rasteve sociale*** | Punonjësi social<br><br>PMF<br><br>Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në familje<br><br>Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit Vau i | Vazhdimisht | Numri i rasteve të të menaxhuara përmes qasjes ndërsektoriale;<br><br>Numri i rasteve që individi është mbështetur me shërbime dhe/ose fuqizuar;<br><br>Numri i takimeve ndërsektoriale të zhvilluara; | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"<br><br>Ligji "Për vetqeverisjen vendore"<br><br>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<br><br>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien | Bashkia | 0 | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Dejës, Bushat, Temal, Hajmel, Vig Mnellë, Shllak | | Numri i përfaqësuesve të institucioneve pjesëmarrës në takime; | familjare”<br><br>VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”. | | | |

***Qëllimi 2- Rintegrim ekonomik për familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme***

| AKTIVITETET | AKTORËT PËRGJEGJËS | AFATI | TREGUESIT | REFERENCA LIGJORE | BURIMI I FINANCIMIT | KOSTO | MONITORIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 1. Krijimi i hapësirave për punësim dhe riintegrim ekonomik për të paktën 20% të punëkërkuesve** | | | | | | | |
| *Aktiviteti 1.1.*<br><br>***Këshillim dhe ndërmjetësim për punësim*** | Specialisti i mbrojtjes dhe fuqizimit ekonomik/Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale<br><br>Sektori i Tatim Taksave | 2021<br><br>2022<br><br>2023 | Marrëveshja me Zyrën e Punës mundëson këshillimin pranë njësive administrative;<br><br>Numri i individëve të këshilluar e ndërgjegjësuar për punësim pranë çdo | Ligji "Për asistencën sociale"<br><br>Ligji "Për nxitjen e Punësimit"<br><br>Urdhëri i Përbashkët i Ministres së Financës dhe Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi Protokollin e | Bashkia<br><br>Partneritet me Zyrën e Punës,<br><br>Qendrën Rajonale të Formimit Profesional,<br><br>Agjensinë e Zhvillimit të | 40,000 | Kabineti i Kryetarit të Bashkisë<br><br>Sekretari i Përgjithshëm |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Administratorët shoqëror pjesë e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit | | njësie administrative;<br><br>Baza e të dhënave të bizneseve dhe institucioneve e organizatave partnere e ngritur;<br><br>Programi dhe Tryeza e zhvilluar janë në përputhje me objektivin e këtij aktiviteti;<br><br>Janë identifikuar forma të ndërveprimit mes Bashkisë-biznesit-Zyrës së Punës-dhe aktorëve të tjerë me qëllim përmbushjen e objektivit të fuqizimit ekonomik të familjeve dhe zbutjes së varfërisë në këtë | Bashkëpunimit mes SHSSH dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit (gusht 2019) | Bujqësisë dega Rajonale Shkodër, si dhe organizata joqeveritare që punojnë për fuqizimin ekonomik | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Bashki;<br><br>Çdo vend pune i krijuar publikohet në ambjentet e Bashkisë dhe njësive administrative;<br><br>Numri i individëve nga grupet në nevojë të punësuar përmes masave të zbatuara të këtij Plani; | | | | |
| ***Aktiviteti 1.2***<br><br>***Financim i projekteve për nxitje biznesei*** | Specialisti i mbrojtjes dhe fuqizimit ekonomik/Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale | 2021<br>2022<br>2023 | Manualet për procedurat operacionale të përgatitura brenda vitit të parë të zbatimit të Planit;<br><br>Thirrja për aplikime është publike dhe komuniteti i targetuar | Ligji "Për asistencën sociale"<br><br>Ligji "Për nxitjen e Punësimit"<br><br>Ligji "për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të | Bashkia | 6,062,500 | Sekretari i Përgjithshëm |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | është gjerësisht i informuar për hapësirat për aplikim;<br><br>Numri i projekteve të biznesit që aplikojnë për mbështetje;<br><br>Numri i projekteve fituese;<br><br>Numri i individëve nga grupet e targetuara (të rinj, viktima dhune, gra kryefamiljare, persona me aftësi të kufizuar) të punësuar përmes bizneseve të ngritura. | kufizuara" | | | |
| **Aktiviteti 1.3**<br><br>***Ngritje e bizneseve sociale*** | Specialisti i mbrojtjes dhe fuqizimit ekonomik/Drejto | 2021<br><br>2022 | Numri i organizatave me të cilat Bashkia ka ndërtuar partneritet për | Ligji "Për asistencën sociale"<br><br>Ligji "Për ndërmarrjet | Bashkia<br><br>Në partneritet me organizata | | Zv. Kryetari<br><br>Sekretari i |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale | 2023 | qëllime të fuqizimit ekonomik të individëve në nevojë;<br><br>Numri i bizneseve sociale të ngritura në territorin e Bashkisë;<br><br>Numri i individëve, pjesë e grupeve në nevojë, të punësuar në biznese sociale; | sociale | joqeveritare | | Përgjithshëm |

*Qëllimi 3 - Ngritja e shërbimeve të kujdesit shoqëror që adresojnë nevojat e grupeve dhe individëve në nevojë për këto shërbime*

| AKTIVITETET | AKTORËT PËRGJEGJËS | AFATI | TREGUESIT | BURIMI I TË DHËNAVE | BURIMI I FINANCIMIT | KOSTO | MONITORIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 1. Brenda vitit 2023 nevojat për shërbime të emergjencës, reabilituese, zhvilluese dhe riintegruese të grupeve në nevojë do të adresohen përmes sistemit komunitar funksional të shërbimeve të kujdesit shoqëror** | | | | | | | |
| ***Aktiviteti 1.1.***<br>***Shërbime për fëmijët dhe familjen***<br>*1. Shërbim ditor për fëmijë dhe sherbim emergjence*<br>*2. Këshillime ligjore falas, këshillim për prindërimin, këshillim për punësimin.*<br>*3. Shërbim psikologjik do të mundësojë terapi jo vetëm* | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale<br>Ekipi i Qendrës Multifunksionale | 2020<br>2021<br>2022 | Infrastruktura e godinës e përshtatëshme për ofrimin e shërbimeve komunitare;<br>Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"<br>VKM 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për | Fondi Social<br>Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia | 34,156,000 | Sekretari i Përgjithshëm |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *për fëmijët, por edhe për prindërit, viktimat e dhunës në familje, përdorues të alkoolit, familje që kanë përjetuar divorc.*<br><br>*4. Shërbim emergjence për individë dhe familje esktremisht të varfëra* | | | standartet kombëtare për shërbimin specifik;<br><br>Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimeve sipas tipit të shërbimit;<br><br>Numri i përfituesve të shërbimeve që ofron qendra;<br><br>Numri i përfituesve të shërbimeve të emergjencës pranë familjeve në territorin e Bashkisë; | përfituesit e shërbimit të organizuar"<br><br>Standarti Kombëtar i miratuar me Udhëzim të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 911, datë 27.12.2018 "Për miratimin e standartit të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore" | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Aktiviteti 1.2**<br><br>***Aksesueshmëria dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara*** | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale<br><br>Në partneritet me strukturat e arsimit, shëndetësisë, zyrën e punës dhe ofruesit e shërbimeve | 2022 | Plani për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara identifikon qartësisht ndërhyrjet që duhet të kryej çdo institucion publik, përfshirë Bashkinë, për të mundësuar respektimin e legjislacionit dhe Konventës Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara.<br><br>Në mënyrë të veçantë | Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara" | Bashkia | 7,284,000 | Kabineti i Kryetarit |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | identifikohen qartësisht godinat dhe mjediset ku duhet të ndërhyhet për ti bërë të aksesueshme.<br><br>Investime të ndërmarra nga Bashkia apo sugjeruar aktorëve të tjerë publik me qëllim garantimin e aksesit të personave me aftësi të kufizuara në mjedise publike. | | | | |
| **Aktiviteti 1.3**<br><br>***Shërbime reabilituese, fuqizuese, riintegruese*** | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe | 2021<br><br>2022 | Infrastruktura e godinës e përshtatëshme për | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"<br><br>VKM 518, datë | Fondi Social<br><br>Ministria e Shëndësisë dhe | 40,898,160 | Sekretari i Përgjithshëm |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***për personat me aftësi të kufizuara***<br><br>*Qendra Ditore Multifunksionale për Personat me Aftësi të Kufizuara:*<br><br>*1. Shërbim ditor ose terapi individuale në përputhje me nevojat e vlerësuara të çdo fëmije me aftësi të kufizuara* ***(nga viti i parë)***<br><br>*2.Për personat me aftësi të kufizuara që kanë përfunduar ciklin arsimor qendra do të ofrojë terapi fizike dhe okupacionale për disa orë në ditë.* ***(nga viti i tretë)***<br><br>*3. Këshillim, orientim, trainim për prindërit/familajrët/ndihmësi t e personave me aftësi të* | përfshirjes sociale<br><br>Ekipi i Qendrës Multifunksionale për PAK | 2023 | ofrimin e shërbimeve;<br><br>Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik;<br><br>Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimeve sipas tipit të shërbimit;<br><br>Numri i përfituesve të shërbimeve që ofron qendra; | 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"<br><br>Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"<br><br>Standarti kombëtar për shërbimin në qendër ditore për personat me aftësi të kufizuara<br><br>Standarti kombëtar | Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *kufizuara* ***(nga viti i parë)***<br><br>*4. Shërbim i lëvizshëm* ***(nga viti i tretë)***<br><br>*5. Informim, orientim dhe këshillim i personave me aftësi të kufizuara, si dhe advokim për të drejtat e tyre* ***(nga viti i dytë)*** | | | Numri i përfituesve të shërbimeve të lëvizshme;<br><br>Numri i familjarëve/ndihmësve të personave me aftësi të kufizuara të ëprfshirë në shërbimet e qendrës;<br><br>Numri i personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë nga programet e informimit, këshillimit, advokimit; | për shërbimin në familje për personat me aftësi të kufizuara; | | | |
| **Aktiviteti 1.4** | Drejtoria e mbrojtjes, | 2021 | Apartamentet funksionale për | Ligji "Për shërbimet | Fondi Social | 5,017,683 | Sekretari i |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Shërbime reabilituese dhe rintegruese për viktimat e dhunës në familje*** | kujdesit dhe përfshirjes sociale<br><br>Koordinatori vendor për masat kundër dhunës në familje | | çdo rast;<br><br>Staf i dedikuar dhe i trainuar për shërbim;<br><br>Numri i rasteve të akomoduara në kushtet e emergjencës;<br><br>Numri i rasteve që kanë përfituar shërbime reabilituese dhe riintegruese; | e kujdesit shoqëror"<br><br>Ligji "'për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare"<br><br>VKM 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"<br><br>Vendim nr.505, datë 13.7.2011 "Për miratimin e standardeve të | Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia | | Përgjithshëm |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike" | | | |
| **Aktiviteti 1.5**<br><br>***Shërbime për të moshuarit***<br><br>*Qendër rezidenciale, ditore dhe shërbim në familje*<br><br>*Shërbimi në familje shtrihet duke filluar nga viti i dytë*<br><br>*Shërbimi ditor në vitin e tretë* | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale | 2021<br><br>2022<br><br>2023 | Infrastruktura e godinës e përshtatëshme për ofrimin e shërbimeve;<br><br>Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik;<br><br>Stafet | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"<br><br>VKM 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"<br><br>Standarti kombëtar për shërbimin rezidencial për të | Fondi Social<br><br>Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia | 14,995,200 | Sekretari i Përgjithshëm |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimeve sipas tipit të shërbimit;<br>Numri i të moshuarve që përfitojnë shërbimin rezidencial;<br>Numri i të moshuarve që përfitojnë shërbimin ditor;<br>Numri i të moshuarve që përfitojnë shërbimin në shtëpi; | moshuarit;<br>Standarti kombëtar për shërbimin ditor për të moshuarit;<br>Standarti kombëtar për shërbimin në familje për të moshuarit; | | | |
| **Aktiviteti 1.6** | Drejtoria e mbrojtjes, | 2020 | Numri i familjeve që kanë përfituar | Ligj "Për strehimin social" | Bashkia dhe Ministria e | 3,240,000 | Sekretari i |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Trajtimi me bonus qeraje i familjeve të pastreha dhe në situatë të vështirë ekonomike*** | kujdesit dhe përfshirjes sociale | 2021 2022 | bonus qeraje/strehim social në raport me numrin e familjeve që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara, gra kryefamiljare, viktima të dhunës në familje, apo individë në nevojë të identifikuar në Planin Social. | Ligj "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë". | Financave | | Përgjithshëm |

*Qëllimi 4: Sistemi komunitar i shërbimeve të kujdesit shoqëror përmbush standartet kombëtare të cilësisë dhe përshtatshmërisë*

| AKTIVITETET | AKTORËT PËRGJEGJËS | AFATI | TREGUESIT | BURIMI I TË DHËNAVE | BURIMI I FINANCIMIT | KOSTO | MONITORIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 1. Sistemi komunitar i shërbimeve i përgjigjet cilësisht nevojave në ndryshim të grupeve vulnerabël** | | | | | | | |
| ***Aktiviteti 1.1 Monitorimi i cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve*** | Punonjësi social/ Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale<br><br>Drejtoria Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Shkodër | 2021<br>2022<br>2023 | Instrumentat e monitorimit të çdo shërbimi janë hartuar në përputhje me standartet kombëtare të shërbimit specifik.<br><br>Çdo shërbim i ngritur me financim nga Fondi Social monitorohet nga | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"<br><br>Standartet kombëtare për çdo formë shërbimi të kujdesit shoqëror të | Bashkia | 551,000 | Sekretari i Përgjithshëm |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | struktura përgjegjëse e Bashkisë;<br><br>Intervistat dhe fokus grupet e realizuara me përfitues të shërbimeve objekt i monitorimit identifikojnë cilësinë e shërbimit nga këndvështrimi i përfituesve<br><br>Raportet e monitorimit vlerësojnë qartësisht cilësinë dhe përshtatshmërinë e shërbimit dhe rekomandojnë | ngritur e të financuar nga Fondi Social | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | ëprmirësimet e nevojshme. | | | | |
| ***Aktiviteti 1.2 Rishikimi periodik i Planit Social*** | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale | 2021<br>2022<br>2023 | Lista e treguesve që do të mblidhen;<br>Frekuenca e mbledhjes së çdo treguesi;<br>Burimi nga do të sigurohet mbledhja e të dhënave;<br>Shkresat zyrtare drejtuar institucioneve që zotërojnë të dhënat e nevojshme;<br>Konsultimet e zhvilluara me institucione publike dhe ofrues | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"<br>Ligji "Për vetqeverisjen vendore<br>Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"<br>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" | Bashkia | | Sekretari i Përgjithshëm<br>Këshilli Bashkiak |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | shërbimesh;<br><br>Numri i konsultimeve të zhvilluara me fëmijët;<br><br>Numri i konsultimeve të zhvilluara me gratë;<br><br>Numri i konsultimeve të zhvilluara me grupe në nevojë;<br><br>Ndryshimet e ndodhura në planet dhe buxhetin lokal sipas propozimeve të marra nga konsultimet e zhvilluara; | Ligji "për asistencën sociale"<br><br>Ligji "Për të drejtën e informimit publik" | | | |

## 5. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Siç shihet në Planin e Veprimit (seksioni 4) për çdo aktivitet të parashikuar është përcaktuar koha e zbatimit, e vlerësuar në përputhje me dy faktorë: (i) Prioriteti i ndërhyrjes, në përputhje me vlerësimin e kryer të nevojave, si dhe (ii) kapaciteti i Bashkisë në këndvështrimin e burimeve njerëzore dhe financiare. Në mënyrë të veçantë ngritja e shërbimeve të kujdesit shoqëror, që kërkon si përgatitje të stafit social të Bashkisë ashtu edhe burime të duhura financiare, është parashikuar të ndodhë gradualisht në harkun kohor tre vjeçar të zbatimit të Planit. Në vitin e parë janë parashikuar të ngrihen shërbimet më të domosdoshme dhe gradualisht deri në vitin e tretë të arrihet ngritja e shportës minimale të shërbimeve.

Në plan është përcaktuar për çdo aktivitet njësia/stafi zbatues i aktivitetit specifik. Edhe pse zbatimi i planit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Bashkisë, në të është specifikuar, atje ku është e nevojshme, partneriteti me institucione të tilla si Shërbimi Social Shtetëror dhe Shërbimi i Punësimit, që kanë përgjegjësi ligjore në zbatimin e aktiviteteve specifike. Megjithatë sidomos në aktivitetet e fuqizimit ekonomik është thelbësore që Bashkia të zgjerojë partneritetin me organizata/ofrues të tjerë, gjë që do të mbetet detyrë e vazhdueshme e strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashki.

Plani do të jetë objekt rishikimi çdo vit veçanërisht në funksion të atyre aktiviteve për të cilat duhet të mbahen në konsideratë zhvillimet afatshkurtra lokale dhe nevojat koherente të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje. Procedurat e rishikimit janë përfshirë gjithashtu në aktivitetet e këtij Plani (shih aktiviteti 1.2, qëllimi 4 i Planit).

Për efekt të monitorimit dhe vlerësimit për çdo aktivitet të Planit është parashikuar njësia/të përgjegjëse për monitorimin e çdo aktivitetit, ndërkohë që për çdo aktivitet është përcaktuar lista e treguesve që lehtësojnë procesin e monitorimit dhe vlerësimit sasior dhe cilësor të çdo aktiviteti.

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit do të jetë verifikimi se sa efektiv ka qenë zbatimi i aktiviteteve, a janë përmbushur në mënyrë të sukseshme qëllimet dhe objektivat e planit dhe mbi të gjitha çfarë ndikimi ka pasur zbatimi tek individët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.

Për të kryer monitorimin do të mblidhen të dhëna dhe informacion i nevojshëm për matjen e treguesve të përcaktuar. Këto të dhëna do të përdoren për të vlerësuar nëse aktivitetet e planifikuara janë zbatuar në praktikë sipas specifikimeve përkatëse të Planit të Veprimit (në sasinë dhe cilësinë e parashikuar), sikurse të dhënat e mbledhura do të japin pamje të qartë

mbi arritjet dhe problematikat që kanë dalë gjatë zbatimit të Planit. Intervista dhe fokus grupe me përfitues të shërbimeve të kujdesit shoqëror janë parashikuar gjithashtu me qëllim vlerësimin gjithëpërfshirës të funksionimit të sistemit që synon të ngrihet përmes zbatimit të këtij plani. Bazuar në detyrimet ligjore, shumë prej aktiviteteve të përfshira në Plan Veprimi janë subjekt i monitorimit, kontrollit apo inspektimit nga institucione kombëtare si: Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektoriati Shëndetësor dhe i Mbrojtjes Sociale. Rezultatet e kontrolleve, monitorimeve apo inspektimeve do të mbahen gjithashtu në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit të Planit nga struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror të Bashkisë.

Të dhënat e mbledhura dhe të analizuara do të jenë bazë e Raportit njëvjeçar. Raporti do të shërbejë gjithashtu edhe për të rishikuar ato elementë të Planit trevjeçar që marrin një fokus të ri për shkak të arritjeve dhe problematikave të identifikuara në periudhën një vjeçare. Gjatë periudhës së zbatimit do të kryhen tre vlerësime, të cilat do të influencojnë drejtpërdrejt ne riorganizimin dhe riformulimin e objektivave specifikë dhe aktiviteteve për vitet pasuese: (i) 2 vlerësime dhe Raporte vjetore (fund i vitit 2021, fund i vitit 2022). Këto raporte do shërbejnë edhe për të rishikuar Planin e Veprimit për vitin pasardhës; (ii) Vlerësimi dhe Raporti përfundimtar (fund i vitit 2023). Ky raport do të shërbejë edhe për të përgatitur Planin pasardhës afatmesëm të Bashkisë.

## REFERENCAT

MPV. (2015). Ligji për qeverisjen vendore. Aksesuar nga http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/userfiles/LIGJI_139_2015_PER_VETEQEVERISJEN_VENDORE1.pdf

Ligj nr, 163/2014 "Për urdhrin e punonjësve social në Republikën e Shqipërisë. Aksesuar nga, http://www.qbz.gov.al/Ligje.pdf/ndihma%20dhe%20perkujdesja%20shoqerore/Ligj_163_04122014_perditesuar.pdf

Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë". Aksesuar nga http://www.qbz.gov.al/Ligje.pdf/ndihma%20dhe%20perkujdesja%20shoqerore/Ligj_121_24112016.pdf

VKM nr. 518, date 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar". Aksesuar nga http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20132/VKM%20nr.%20518,%20date%204.9.2018.pdf

VKM nr. 149, datë 13.3.2018 "Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare" Aksesuar nga http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2037/VKM%20nr.%20149,%20date%2013.3.2018.pdf

VKM nr.136, datë 7.3.2018 "Për funksionimin dhe administrimin e Rregjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror". Aksesuar nga http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2034/VKM%20nr.%20136,%20date%207.3.2018.pdf

Ligji nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit. Aksesuar nga http://www.ikub.al/LIGJE/610310002/Article-Per-statusin-e-jetimit-.aspx

VKM nr.233, datë 10.04.1998 "Për zbatimin e ligjit për statusin e jetimit". Aksesuar nga http://www.sherbimisocial.gov.al/ëp-content/uploads/2014/10/VKM-NR.233-Dt.10.04.1998-Jetimit.pdf

VKM nr. 499, datë 29.08.2018 "Për miratimin e procedurave standarte të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit". Aksesuar nga

http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20127/VKM%20nr.%20499,%20date%2029.8.2018.pdf

Ligj nr.22/2018 "Për strehimin social". Aksesuar nga http://www.sherbimisocial.gov.al/ëp-content/uploads/2018/06/ligj-nr.-22-dt.-3.5.2018-Per-strehimin-social.pdf

Ligj nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Aksesuar nga https://www.uart.edu.al/media/150329-Ligji 10221_ 2010 per mbrojtjen nga%20 diskriminimi.pdf

Ligj nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin 120/2014 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Aksesuar nga http://www.idp.al/ëp-content/uploads/2016/11/Ligji_9887_date_10_-03_2008_i_ndryshuar-2.pdf

MMSR. (2017). Axhenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës. Aksesuar nga http://femijet.gov.al/al/ëp-content/uploads/2017/06/Agjenda-kombetare-per-te-drejtat-e-femijeve.pdf

MMSR. (2017). Ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Aksesuar nga http://femijet.gov.al/al/ëp-content/uploads/2017/07/LIGJI-NR-18-2017-%E2%80%9CP%C3%8BR-T%C3%8B-DREJTAT-DHE-MBROJTJEN-E-F%C3%8BMIJ%C3%8BS%E2%80%9D.pdf

KM. (2018). VKM Nr. 578, datë 3.10.2018 'Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes'. Aksesuar nga http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20144/VKM%20nr.%20578,%20date%203.10.2018.pdf

KM. (2018). VKM Nr. 54, datë 31.1.2018 "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës'. Aksesuar nga http://femijet.gov.al/al/ëp-content/uploads/2018/08/VKM-nr.-54-date-31.1.2018.pdf

KM. (2018). VKM Nr. 353, datë 12.6.2018 "Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive administrative' Aksesuar nga http://femijet.gov.al/al/ëp-content/uploads/2018/08/VKM-nr.-353-date-12.6.2018.pdf

KM. (2018). VKM Nr. 148, datë 13.3 2018 "Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës". Aksesuar nga http://femijet.gov.al/al/ëp-content/uploads/2018/08/VKM-nr.-148-date-13.3.2018.pdf

KM. (2018). VKM Nr. 91, dt 14.02.2018c " Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës". Aksesuar nga http://femijet.gov.al/al/ëp-content/uploads/2018/08/VKM-Nr-91-dt-14.02.2018.pdf

Ligji Nr. 47/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar'. Aksesuar nga http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20115/LIGJ%20nr.%2047-2018,%20date%2023.7.2018.pdf

KM. (2011). VKM Nr. 334, datë 17.2.2011, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij". Aksesuar nga https://www.ilo.org/dyn/natlex/docs/ELECTRONIC/94182/110439/F-428843712/ALB-94182.pdf

KM. (2011). Ligji për inspektimin. Aksesuar nga http://inspektoriatipunes.gov.al/ëp-content/uploads/2014/02/Ligj_10433_16.06.2011.pdf

MMSR. (2015). Standardet për shërbimet në Qendrën Kombëtare Tranzit të Emergjencës. Aksesuar nga http://femijet.gov.al/al/ëp-content/uploads/2015/07/Vendim-Nr.-573-datë-24.6.2015-Për-miratimin-e-Standardeve-të-Shërbimeve-të-Njësive-të-Mbrojtjes-së-Fëmijëve.pdf

MMSR. (2015). Standardet e shërbimeve të njësive të mbrojtjes së fëmijës. Aksesuar nga http://femijet.gov.al/al/ëp-content/uploads/2015/07/Vendim-Nr.-573-datë-24.6.2015-Për-miratimin-e-Standardeve-të-Shërbimeve-të-Njësive-të-Mbrojtjes-së-Fëmijëve.pdf

MMSR. (2013). Standardet e shërbimeve të kujdesit social për fëmijët në nevojë në qendrat ditore. Aksesuar nga http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/54-2013.pdf

MMSR. (2011). Standardet e shërbimeve të kujdesit social për viktimat e dhunës në familje në qendrat rezidenciale publike dhe jopublike. Aksesuar nga http://www.sherbimisocial.gov.al/ëp-content/uploads/2016/12/Vendim-i-KM_505_13.07.2011-dhuna-rez.pdf

MMSR. (2010). Standardet e shërbimeve të kujdesit alternativ për fëmijët në nevojë. Aksesuar nga http://www.sherbimisocial.gov.al/ëp-content/uploads/2016/12/VENDIM-Nr.752-dat%C3%AB-8.9.2010-Per-standartet-e-kujdestarise.pdf

MMSR. (2007). Standardet e shërbimeve shoqërore për personat e trafikuar ose personat në rrezik për trafikim, në qendrat rezidenciale. Aksesuar nga http://www.sherbimisocial.gov.al/ëp-content/uploads/2016/12/Vendim-i-KM_195_11.04.2007-trafikimi-rez.pdf

MMSR. (2006). Standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar në institucionet rezidenciale dhe ditore. Aksesuar nga http://inspektoriatipunes.gov.al/ëp-content/uploads/2014/02/Vendim-i-KM_822_06.12.20061.pdf

MMSR. (2005). Standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Aksesuar nga http://inspektoriatipunes.gov.al/ëp-content/uploads/2014/02/Vendim-i-KM_658_17.10.2005.pdf

# SHTOJCA 1: PROFILI DHE KARAKTERISTIKAT E KATEGORIVE NË NEVOJË PËR SHËRBIME TË KUJDESIT SHOQËROR

## *1. Tregues demografik*

*Tabela 1: Të dhëna të popullsisë dhe familjeve*

| Njësia Administrative | Numri Popullsisë | Numri Familjeve | Popullsia sipas grup moshave | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 0-6 vjeç | 7-15 vjeç | 16-18 vjeç | 19-64 vjeç | 65+ vjeç |
| Vau Dejes dhe Temal | 15 749 | 4 738 | 1 521 | 2 077 | 719 | 10 034 | 1 398 |
| Bushat | 24 934 | 6 358 | 2 154 | 3 002 | 1 049 | 16 062 | 2 667 |
| Hajmel dhe Vig Mnele | 9 169 | 2 766 | 853 | 1 185 | 368 | 5 817 | 946 |
| Shllak | 1 956 | 668 | 231 | 304 | 111 | 1 177 | 133 |
| **TOTALI** | **51 808** | **14 530** | **4 759** | **6 568** | **2 247** | **33 090** | **5 144** |

## *2. Familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme*

*Tabela 2. Të dhëna të krahasuara për familjet aplikuese dhe përfituese të NE 2018, 2020*

| Njesia administrative | DHJETOR 2018 | | | | PRILL 2020 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Familje aplikuese | Familje Perfituese | | | Familje aplikuese | Familje Perfituese | | |
| | | Rural | Urban | % pranimit | | Rural | Urban | % pranimit |
| Bushat | 178 | 160 | | 90% | 165 | 151 | | 92% |
| Vau Dejës | 281 | 152 | 102 | 90% | 279 | 157 | 115 | 98% |
| Hajmel | 208 | 200 | | 96% | 216 | 207 | | 96% |
| Vig Mnel | 117 | 113 | | 97% | 120 | 120 | | 100% |
| Temal | 161 | 153 | | 95% | 151 | 149 | | 99% |
| Shllak | 149 | 139 | | 93% | 156 | 148 | | 95% |
| **TOTALI** | **1094** | **917** | **102** | **93%** | **1087** | **932** | **115** | **96%** |

7.2% e familjeve në Bashkinë Vau i Dejës përfitojnë ndihmën ekonomike. 1087 familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme aplikuan për ndihmën ekonomike në Bashkinë Vau i Dejës në muajin prill 2020[18].

Prej tyre 935 familje përfituan ndihmën përmes aplikimit të formulës së pikëzuar dhe 112 të tjera përfituan nga fondi 6%. Për rrjedhojë 96% e familjeve aplikuese përfituan ndihmën ekonomike.




*Grafik 1: Familje përfituese të ndihmës ekonomike sipas njësive administrative*

Nga krahasimi i këtyre të dhënave me të dhënat e dhjetorit të vitit 2018, viti kur u aplikua për herë të parë modeli i ri i ndihmës ekonomike, shohim që kjo skemë nuk ka pësuar ndryshime të rëndësishme. Në dhjetor 2018 aplikuan për ndihmë ekonomike 1094 familje (vetëm 7 familje më shumë se 2020) dhe përfituan ndihmën në total 1019 familje.

Njësitë administrative Vau i Dejës dhe Hajmel kanë numrin më të lartë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, ndërsa njësitë administrative Bushat, Temal dhe Shllak kanë pothuajse të njëjtin numër familjesh përfituese. Numrin më të ulët të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike e ka njësia Vig Mnel.




Nëse krahasojmë numrin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike me numrin e familjeve të rregjistruara në gjendjen civile shohim se njësia administrative Shllak ka përqindjen më të lartë të familjeve në ndihmë ekonomike (49% e familjeve në këtë njësi jetojnë me ndihmë ekonomike), Hajmel dhe Vig Mnel kanë 26% të familjeve, Vau i Dejës dhe Temali 20% dhe Bushati vetëm 5%.

*Grafik 2: Përqindja e familjeve përfituese të NE ndaj familjeve të njësive administrative*

Nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror për familjet përfituese të ndihmës ekonomike ndryshojnë në përputhje me karakteristikat e këtyre familjeve, si dhe të grup moshave që i përbëjnë ato. Të dhënat e

[18] *Burimi: Rregjistri Elektronik Kombëtar i Ndihmës Ekonomike*

Rregjistrit Elektronik të ndihmës ekonomike për muajin prill 2020 japin 4,525 individë pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Pra 8,7% e popullsisë në Bashkinë e Vaut të Dejës janë pjesë e familjeve pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.

*Tabela 3: Individë në familjet përfituese të ndihmës ekonomike (prill 2020)*

| Njesia administrative | 0-18 vjeç | 19-64 vjeç | Mbi 64 vjeç |
|---|---|---|---|
| Bushat | 354 | 398 | 6 |
| Vau Dejës | 420 | 658 | 19 |
| Hajmel | 358 | 557 | 19 |
| Vig Mnel | 157 | 316 | 11 |
| Temal | 264 | 364 | 7 |
| Shllak | 246 | 366 | 5 |
| **TOTALI** | **1799** | **2659** | **67** |

*Grafik 3: Përbërja e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike*




40% e pjesëtarëve në familjet përfituese të ndihmës ekonomike janë fëmijë (1,799 fëmijë). 13% e fëmijëve në Bashkinë Vau i Dejës jetojnë në familje me të ardhura të pamjaftueshme.

59% e pjesëtarëve të këtyre familjeve i përkasin grupmoshës 19-64 vjeç (2,659 individë). 8% e individëve të kësaj grupmoshe jetojnë në familje me të ardhura të pamjaftueshme.

Vetëm 1% e pjesëtarëve të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike i përkasin grupmoshës mbi 64 vjeç, pra 1% e individëve të kësaj grupmoshe jetojnë në familje me të ardhura të pamjaftueshme.

Numri mesatar i pjesëtarëve në familjet përfituese të ndihmës ekonomike është 4,3, pra më i lartë se mesatarja në Bashki (3,5). Të tjera karakteristika të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike jepen në tabelën 4.

*Tabela 4: Karakteristikat e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike*

| BASHKIA | TOTAL | KARAKTERISTIKAT | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Familje përfituese të NE | Kryefamiljare grua | Deri në 2 fëmijë të mitur | Mbi 2 fëmijë të mitur | Rome/ egjiptiane | Me të paktën 1 anëtar PAK | Të paktën 1 pjestar në moshë pensioni |
| Bushat | 151 | 10 | 89 | 48 | 0 | 25 | 6 |
| Vau Dejës | 272 | 25 | 133 | 64 | 0 | 57 | 15 |
| Hajmel | 207 | 9 | 101 | 43 | 0 | 27 | 17 |
| Vig Mnel | 120 | 4 | 49 | 24 | 0 | 19 | 8 |
| Temal | 149 | 13 | 74 | 37 | 0 | 24 | 6 |
| Shllak | 148 | 10 | 79 | 33 | 0 | 25 | 4 |
| **TOTALI** | **1047** | **71** | **525** | **249** | **0** | **177** | **56** |

Duket se përveçse familje me shumë anëtarë, predominojnë familjet me fëmijë të mitur. 50% e familjeve me ndihmë ekonomike kanë deri në 2 fëmijë të mitur dhe 24% e tyre kanë mbi 2 fëmijë. 17% e familjeve përfituese të ndihmës kanë të paktën një pjesëtar me aftësi të kufizuar. 6,8% e këtyre familjeve kanë gruan kryefamiljare dhe 5.3% kanë të paktën një pjesëtar në moshë pensjoni.

Zyra e Punës raportoi 690 punëkërkues të rregjistruar nga Bashkia Vau i Dejës. 244 prej tyre (35%) janë pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Në përputhje me ligjin "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" individët në moshë madhore nga familjet përfituese të ndihmës ekonomike që jetojnë në zonën urbane kanë detyrimin e rregjistrimit në Zyrën e Punës, si dhe të pranimit të ofertës së punës dhe kursit të formimit profesional si kusht për të aplikuar për përfitimin e ndihmës ekonomike.

*Tabela 5: Të dhëna mbi punëkërkuesit e rregjistruar në Zyrën e Punës për Bashkinë Vau i Dejës*

| Bashkia | Grupmosha | Gjithsej | Sipas gjinisë | | Sipas statusit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Femra | Meshkuj | PAK | Romë/ Egjiptjane | Emigrate te kthyer | Gra kryefamijare |
| VAU I DEJËS | 16-19 vjec | 33 | 18 | 15 | | | | 3 |
| | 20-24 vjec | 82 | 47 | 35 | | | | 5 |
| | 25-29 vjec | 74 | 38 | 36 | 3 | | | 6 |
| | 30-39 vjec | 124 | 78 | 46 | | | 2 | 5 |
| | 40+ | 377 | 229 | 148 | 3 | | 2 | 27 |
| | **Total** | **690** | **410** | **280** | **6** | **0** | **4** | **46** |

Siç shihet në tabelën 6, përqindja më e lartë e punëkërkuesve nga familje me ndihmë ekonomike është një njësinë administrative Vau i Dejës (49%). Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë faktin që numri i individëve të grupmoshës aktive për punë në familje me ndihmë ekonomike në këtë njësi administrative është 658 persona, konkludojmë se vetëm 32% e tyre janë të rregjistruar në Zyrën e Punës.

*Tabela 6: Të dhëna krahasuese mbi punëkërkuesit e papunë dhe punëkërkuesit nga familje me ndihmë ekonomike*

| NJESIA ADMINISTRATIVE | FEMRA | MESHKUJ | TOTALI | NGA FAMILJE ME N.E | PERQINDJA E INDIVIDEVE N.E/ PUNEKERKUES |
|---|---|---|---|---|---|
| Bushat | 126 | 67 | **193** | **21** | 11% |
| Vau Dejes | 246 | 177 | **423** | **208** | 49% |
| Hajmel | 20 | 19 | **39** | **4** | 10% |
| Vig Mnel | 4 | 1 | **5** | **1** | 20% |
| Temal | 2 | 7 | **9** | **2** | 22% |
| Shllak | 12 | 9 | **21** | **8** | 38% |
| **TOTALI** | **410** | **280** | **690** | **244** | **35%** |

Të dhënat e Zyrës së Punës na ndihmojnë për të analizuar karateristikat e punëkërkuesve aktualë në Bashkinë Vau i Dejës. Specifikisht:

Më të vështirë për të siguruar një punë e kanë femrat se sa meshkujt. 59% e punëkërkuesve janë femra dhe 41% janë meshkuj; 6,6% e punëkërkuesve janë gra kryefamiljare; Ka një nivel të ulët të rregjistrimit për punë të personave me aftësi të kufizuara. 0,9% janë persona me aftësi të kufizuara. Mungojnë analizat mbi arsyet që i mbajnë ata larg tregut të punës.




Më të vështirë sigurimin e një pune e kanë personat me moshë mbi 40 vjeç. 55% e personave në kërkim të një pune kanë moshë mbi 40 vjeç.

*Grafiku 4: Numri i punëkërkuesve sipas arsimit*

Mungesa e një profesioni është një arsye që nuk u krijon mundësi për punësim individëve të rregjistruar në Zyrën e Punës. Vetëm 10% e punëkërkuesve kanë arsim profesional ose të lartë.

### *3. Personat me Aftësi të Kufizuara*

Në Bashkinë Vau i Dejës 1,8% e popullsisë (909 individë) kanë të paktën një formë të aftësisë së kufizuar sipas vlerësimit mjeksor dhe përfitojnë nga programi kombëtar i pagesave të aftësisë së kufizuar.

*Tabela 7: Të dhëna për personat me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative*

| EMERTIMI | GJITHSEJ | | TE VERBER | | PARA-TETRA | PLEGJIK | PAK FIZIK | MENDOR |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | Me kujdestar | Gjithsej | Me kujdestar | Gjithsej | Me kujdestar | Gjithsej | Me kujdestar |
| Bushat | 363 | 99 | 57 | 16 | 26 | 26 | 280 | 57 |
| Vau Dejës | 277 | 68 | 27 | 5 | 28 | 28 | 222 | 35 |
| Hajmel | 116 | 35 | 21 | 4 | 7 | 7 | 88 | 24 |
| Vig Mnel | 39 | 11 | 9 | 4 | 3 | 3 | 27 | 4 |
| Temal | 61 | 15 | 9 | 4 | 2 | 2 | 50 | 9 |
| Shllak | 53 | 10 | 4 | 2 | 2 | 2 | 47 | 6 |
| **TOTALI** | **909** | **238** | **127** | **35** | **68** | **68** | **714** | **135** |

*Grafik 5: Karakteristikat e aftësisë së kufizuar*




26% e tyre ka një formë të rëndë të aftësisë së kufizuar dhe për ta kujdeset një person ndihmës që gjithashtu përfiton pagesë nga programi kombëtar. 79% e personave me aftësi të kufizuara janë PAK fizik ose mendorë.




*Grafik 6: Persona me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative.*

Përqindjen më të lartë të personave me aftësi të kufizuara e gjejmë në njësitë administrative Bushat (40%) dhe Vau i Dejës (30%).

Në Hajmel jetojnë 13% e personave me aftësi të kufizuara.

Në Temal, Shllak dhe Vig Mnel ka një përqindje më të ulët të tyre (4-7%).

Mes 909 personave me aftësi të kufizuara 12,4% janë fëmijë. Duke ju referuar totalit të 13,574 fëmijëve të rregjistruar në këtë Bashki, 0,8% e tyre kanë një formë të aftësisë së kufizuar dhe kanë të nevojshme shërbime zhvilluese/reabilituese.

*Tabela 8: Fëmijë me aftësi të kufizuar sipas grupmoshave dhe njësive*

| Njësia administrative | Grupmoshat | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | 0-6 vjeç | 6-15 vjeç | 15-18 vjeç |
| Bushat | 19 | 7 | 8 | 4 |
| Vau Dejës | 49 | 8 | 30 | 11 |
| Hajmel | 12 | 1 | 10 | 1 |
| Vig Mnel | 5 | 1 | 2 | 2 |
| Temal | 12 | 3 | 5 | 4 |
| Shllak | 16 | 1 | 13 | 2 |
| **TOTALI** | **113** | **21** | **68** | **24** |

### *4. Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje*

1,923 fëmijë në Bashkinë e Vaut të Dejës u identifikuan në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje. Duke e krahasur më totalin e fëmijëve të rregjistruar në Bashkinë Vau i Dejës (13,574 fëmijë) mund të themi se në nivel Bashkie 14% e fëmijëve kanë të nevojshëm të paktën një formë shërbimi kujdesi shoqëror.

*Tabela 9: Të dhëna për fëmijët sipas njësive administrative*

| Njësia Administrative | Fëmijë sipas gjendjes civile | Fëmijë në nevojë për mbrojtje e përkujdesje | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Të dhunuar/shfrytëzuar | Jetimë | Në familje me ndihmë ekonomike | Me aftësi të kufizuara | Gjithsej |
| Bushat | 6205 | 3 | 3 | 354 | 19 | 379 |
| Vau i Dejës | 4317 | 3 | | 420 | 49 | 472 |
| Temal | | 0 | | 264 | 12 | 276 |
| Hajmel | 2406 | 2 | | 358 | 12 | 372 |
| Vig Mnel | | 0 | | 157 | 5 | 162 |
| Shllak | 646 | 0 | | 246 | 16 | 262 |
| **Totali** | **13574** | **8** | **3** | **1799** | **113** | **1923** |

### *5. Viktimat e dhunës në familje*

*Grafiku 7: Rastet e dhunës për vitet 2018-2019*




Siç shihet nga grafiku 7, raste dhune janë raportuar në katër njësi administrative:

50% nga njësia administrative Vau i Dejës; 35% nga njësia administrative Bushat; 12% nga njësia administrative Hajmel; 3% nga njësia administrative Vig Mnel;

### *6. Të moshuar në nevojë për shërbime*

*Tabela 10. Te dhëna mbi të moshuarit në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror*

| Njësia administrative | Të moshuar që kanë kerkuar shërbime në familje | Të moshuar që kanë kerkuar shërbime ne qendër ditore | Të moshuar që kanë kërkuar sherbime në qendër rezidenciale | Të moshuar që jetojne vetëm dhe përfitojnë ndihme ekonomike |
|---|---|---|---|---|
| Bushat | 1 | | | 6 |
| Vau Dejes | 0 | | | 19 |
| Hajmel | 0 | | | 19 |
| Vig Mnel | 0 | | | 11 |
| Temal | 0 | | | 7 |
| Shllak | 0 | | | 5 |
| **TOTAL BASHKIA** | **1** | **0** | **11** | **67** |

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki raporton për 67 të moshuar që jetojnë vetëm dhe përfitojnë ndihmën ekonomike. Duke mbajtur në konsideratë që në Bashkinë Vau i Dejës janë të rregjistruar 5,144 persona me moshë mbi 65 vjeç, mund të themi se 1,3% e tyre kanë të nevojshme mbështetjen me shërbime specifike në kushtet që masa e ndihmës ekonomike është e ulët dhe jetesa për këta individë është më e vështirë.




*Grafik 8: Nevojat për shërbime sipas njësive administrative*

Siç shihet në grafikun 8, të moshuar në nevojë për shërbime ka në çdo njësi administartive, por në përqindje më të lartë ata janë në Vaun e Dejës dhe Hajmel (respektivisht 28%).

## SHTOJCA 2. TREGUES TË SHËRBIMEVE EGZISTUESE

*Tabela 1: Shërbimi pikologjik dhe niveli i braktisjes së shkollës në shkollat 9 vjeçare*

| NJA | Nr. Shkollash | Kapaciteti | Nr nxënësish | Niveli i Braktisjes së shkollës | Nr mësuesish | Nr psikologësh |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Bushat** | 11 | 1306 | 1206 | 2 | 133 | 1 |
| **Vau Dejes** | 4 | 1200 | 918 | 0 | 88 | 1 |
| **Hajmel** | 4 | 520 | 318 | 0 | 59 | 0 |
| **Vig Mnel** | 1 | 300 | 85 | 0 | 7 | 0 |
| **Temal** | 4 | 80 | 66 | 0 | 12 | 0 |
| **Shllak** | 2 | 20 | 0 | 0 | 11 | 0 |
| Total | 26 | 3126 | 2593 | 2 | 310 | 2 |

*Tabela 2: Shërbimi psikologjik dhe ndjekja e shkollës së mesme*

| Njësia administrative | Nr. Shkollash | Kapaciteti | Nr nxënësish | Niveli i Braktisjes së shkollës | Nr mësuesish | Nr psikologësh |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Bushat | 2 | 600 | 427 | 2 | | 1 |
| Vau Dejes | 2 | 230 | 184 | 0 | | 1 |
| Hajmel | 2 | 140 | 123 | 0 | | 0 |
| Vig Mnel | 0 | 150 | 0 | 0 | | 0 |
| Temal | 0 | 100 | 0 | 0 | | 0 |
| Shllak | 0 | 80 | 0 | 0 | | 0 |
| **Total** | **6** | **1300** | **824** | **2** | **318** | **2** |

*Tabela 3: Shërbime publike dhe jo publike të kujdesit shoqëror*

| SHERBIME EKZISTUESE | TIPI | PUBLIKE | JOPUBLIKE | KAPACITETI MAX | NR AKTUAL I PËRFITUESVE | NJËSIA ADMINISTRATIVE |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Sherbime per te moshuarit*** | | | | | | |
| 1.Qendra "Besa "Barbullush | Ditore | x | | 30 | 0 | Bushat |
| | Rezidenciale | | | 32 | 24 | |
| 2.Shtepia e Bamiresise | Rezidenciale | | x | 10 | 3 | Vau Dejes |
| ***Sherbime per femijet***<br>**1**.Qendra Multifunksionale "Mark Quni" Kopsht | Gjysme ditore | | x | 25 | 13 | Bushat |
| ***Sherbime per PAK*** | | | | | | |
| 1.Shoqata Rreze Shprese | Ditore | | x | 20 | 20 | Vau Dejes |
| 2.Qendra Multifunksionale "Mark Quni" | Gjysme Ditore | | x | 10 | 6 | Bushat |
| 3. Qendra e reabilitimit Don Antonio Sharra "Papa Xhovani XIII" | Rezidenciale | | x | 12 | 2 | Hajmel |
| 4. Vellezerit e Nane Terezes | Rezidenciale | | x | 32 | 30 | Bushat |

## SHTOJCA 3. SHPORTA E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

### *Familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme*

Janë dy ligje që ndërthuren dhe që synojnë adresimin e nevojave të familjeve pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme. Ligji 57/2019[1] "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", dhe Ligji 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e Shqipërisë".

Në përputhje me Ligjin 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", neni 11 "Pagesa e ndihmës ekonomike", ndihma ekonomike është një pagesë e kufizuar në kohë, që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara në ligj. Përfitues të ndihmës ekonomike, në përputhje me nenin 6 të po këtij ligji janë: (i) Familjet në nevojë që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme; (ii) Jetimët, të cilët nuk janë në institucione; (iii) Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë; (iv) Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre; (v)Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore; (vi) Fëmijët e vendosur në familje kujdestare sipas përcaktimeve në ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

Ligji 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të tij synojnë të ngrenë shërbime të kombinuara që në thelb nxisin fuqizimin e individëve madhorë të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Në gusht 2019 Ministria e Financës dhe Ekonomisë (Ministria përgjegjëse për politikat e nxitjes së punësimit) dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (përgjegjëse për politikat e mbrojtjes e përkujdesit social) publikuan një Urdhër të Përbashkët[1] të dy Ministreve që kërkon zbatimin e një Protokolli Bashkëpunimi mes Shërbimit Social Shtetëror dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit me qëllim punësimin e individëve madhorë (në moshë pune) të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike.

Për fuqizimin e individëve në moshë pune të familjeve të ndihmës ekonomike mund të parashikohen këto ndërhyrje: (i) Program për fuqizimin ekonomik- përfshin një numër masash bazuar në kapacitetet e Bashkisë dhe institucioneve të tjera lokale. (ii) Informimi dhe këshillimi për punësim per përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshtatshme për punësim sipas kapacitetetit dhe nevojave individuale.

### *Personat me Aftësi të Kufizuara*

Në Shqipëri egziston tashmë një paketë e gjerë ligjore që në thelb synon të garantojë respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Janë tre komponentë të rëndësishëm të ndërthurur tërësisht me njëri-tjetrin që duhen adresuar nga çdo Bashki me qëllim mbrojtjen, përfshirjen dhe përkujdesin shoqëror të personave me aftësi të kufizuara: (i) Përmbushja e nevojave për shërbime reabilituese dhe zhvilluese të personave me aftësi të kufizuara (programi kombëtar i pagesave për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimet); (2) garantimi i të drejtave thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e tyre, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë këta persona në kushte të barabarta me të tjerët; (3) garantimi i jetesës së pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara që zgjedhin të jetojnë në mënyrë të pavarur, duke rritur në maksimum autonominë e tyre dhe vendimmarrjen e pavarur, me synimin për të garantuar jetën në komunitet në kushte të barabarta me të tjerët;

Për personat me aftësi të kufizuara ligji për shërbimet dhe aktet nënligjore të tij parashikojnë këto forma shërbimesh: (i) Shërbime rehabilituese per personat në nevojë për aftësim fizik; (ii) Shërbimet në familje për persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare dhe qe e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal; (iii) Shërbimi i strehimit të mbrojtur per personat me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë një strehë.

### *Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje*

Janë dy ligje që të ndërthurura me njëra tjetrën që janë bazë në analizën për mbrojtjen dhe përkujdesjen për fëmijët: 1. Ligji 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" dhe Ligji[1]nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

Në këndvështrimin e garantimit të mbrojtjes që duhet ti mundësohet çdo fëmije Ligji 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" përcakton mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, bashkë me detyrat specifike që garantojnë ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave me efektivitet, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës. Strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor janë: Bashkia; Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki; Njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki; Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësive administrative;Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

Neni 34 në kreun III "Mekanizmat institucional për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" përcakton si mekanizëm këshillimor dhe koordinues institucional në nivelin vendor grupin teknik ndërsektorial në nivel bashkie apo njësie administrative.

Ndërkohë shërbimet kryesore që parashikojnë aktet nënligjore të ligjit 121/2016 për shërbimet e kujdesit shoqëror janë: (i) Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line, shërbim i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës; (ii) Shërbimi i përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror, per zhvillimin, arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në një mjedis familjar të caktuar, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi. (iii) Qendrat ditore per fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike; (iv) Qendrat ditore per fëmijë me aftësi të kufizuara; (v) Shërbime zhvilluese dhe rehabilituese për fëmijë me çrregullime pervazive të zhvillimit; me prapambetje mendore; me çrregullime në komunikim; në nevojë për aftësim fizik; (vi) Shërbimi i emergjencës 72 orë per fëmijët pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe fëmijë me aftësi të kufizuara;

### *Viktimat e dhunës në familje*

Në përputhje me ligjin 47/2018 që ka sjellë ndryshime të Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdheniet familjare" njësitë e qeverisjes vendore kanë këto detyra: (i) Angazhimin në krijimin e strukturave të shërbimit social për rastet e dhunës në familje; (ii) Instalimin e një linje telefonike rajonale 24-orëshe, e cila më pas krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe OJF-të, duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin mes tyre; (iii) Ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, si dhe koordinimin e punës me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse. (iv) Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrit të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit.

Ndërkohë Bashkia ka detyrimin për ngritjen dhe funksionimin e: (i) Komiteteve Drejtuese lokale që drejtohen nga Kryetari i Bashkisë dhe janë komitete koordinuese ad hoc; (ii) Ekipi teknik ndërdisiplinor që ngrihet me vendim të komitetit drejtues më qëllim bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse në nivel vendor në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje; (iii) Pranë çdo bashkie caktohet koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, i cili është përfaqësuesi i zyrës së shërbimeve sociale pranë asaj njësie të qeverisjes vendore;

Shërbimet bazë të parashikuara nga aktet nënligjore të ligjit për shërbimet sociale për viktimat e dhunës në familje janë: (i) Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line, shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; (ii) Shërbimi i emergjencës 72 orë,per viktima të dhunës në familje dhe fëmijët që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situate që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur. (iii) Shërbimi i strehimit të mbrojtur per viktimat e dhunës në familje, viktimave të trafikimit të cilët nuk kanë një strehë. Organizohet në formën e një strukture banimi të veçantë, sipas specifikave të grupit të përfituesve ose në formën e banesave individuale.

### *Familje që kërkojnë mbështetje për strehim*

Ligji 22/2018 "Për strehimin social" përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse. Programet e strehimit sipas këtij ligji përfshijnë: Bonusi i qerasë; banesa sociale me pagesë të reduktuar; kreditë e buta.

### *Të moshuar në nevojë për shërbime*

Të moshuarit janë një nga grupet e parashikuara në ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror. Shërbimet e parashikuara në nivel komunitar për ta në aktet nënligjore përfshijnë: (i) Shërbimet në familje për të moshuar të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, të cilët e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal. (ii) Qendra ditore per të moshuarit;

### *Familje që kanë përjetuar divorc*

Shërbimet e parashikuara në nivel komunitar për ta përfshijnë shërbimin psikosocial. Megjithatë nevojat përcaktohen gjatë menaxhimit të rasteve dhe shpesh janë më komplekse. Ato mund të përfshijnë edhe strehimin social.

### *Përdorues të alkoolit*

Shërbimet e parashikuara në nivel komunitar për ta përfshijnë shërbimin psikosocial.

## SHTOJCA 4. BUXHETI I DETAJUAR

*Formati excel bashkangjitur*

| Objektivi | Kosto ( leke, per 3 vjet) | Buxheti lokal | Donatore te angazhuar | Hendeku i financimit |
|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi 1 – BASHKIA VAU I DEJËS DO TË KETË BURIMET NJERËZORE DHE KAPACITETET E NEVOJSHME PËR TË ADRESUAR CILËSISHT NEVOJAT E GRUPEVE VULNERABËL** | 9,994,200 | 206,400 | 1,000,000 | 8,787,800 |
| **Objektivi 1 – Brenda vitit 2021 strukturat e shërbimeve sociale në Bashki dhe njësi administrative do të kenë kapacitetet e nevojshme për të përmbushur cilësisht detyrimet ligjore** | 8,921,300 | - | 1,000,000 | 7,921,300 |
| **Objektivi 2 – Rritja e rasteve të identifikuara dhe mbështetura me shërbime të mbrojtjes e përkujdesit social** | 1,072,900 | 206,400 | - | 866,500 |
| **Qëllimi 2 - RINTEGRIM EKONOMIK PËR FAMILJET PA TË ARDHURA OSE ME TË ARDHURA TË PAMJAFTUESHME** | 6,102,500 | 102,500 | - | 6,000,000 |
| **Objektivi 1 – Mbështetja dhe Fuqizimi i familjeve në nevojë** | 6,102,500 | 102,500 | - | 6,000,000 |
| **Qëllimi 3 –NGRITJA E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR QË ADRESOJNË NEVOJAT E GRUPEVE DHE INDIVIDËVE NË NEVOJË PËR KËTO SHËRBIME** | 105,591,043 | 3,240,000 | - | 56,435,200 |
| **Objektivi 1 – Brenda vitit 2023 nevojat për shërbime të emergjencës, reabilituese, zhvilluese dhe riintegruese të grupeve në nevojë do të adresohen përmes sistemit komunitar funksional të shërbimeve të kujdesit shoqëror** | 105,591,043 | 3,240,000 | - | 56,435,200 |
| **Qëllimi 4 – SISTEMI KOMUNITAR I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR PËRMBUSH STANDARTET KOMBËTARE TË CILËSISË DHE PËRSHTATSHMËRISË** | 551,000 | 69,000 | - | 482,000 |
| **Objektivi specifik 1-Sistemi komunitar i shërbimeve i përgjigjet cilësisht nevojave në ndryshim të grupeve vulnerabël** | 551,000 | 69,000 | - | 482,000 |
| **TOTAL** | **122,238,743** | **3,617,900** | **1,000,000** | **71,705,000** |

| Aktivitetet | Aktorët përgjegjës | Afatet | Treguesit | Burimi i të dhënave | Financimi | Monitorimi | Kosto | Buxheti lokal | Donatore | Hendeku I financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 1 – Krijimi i hapësirave për punësim dhe reintegrim ekonomik për të paktën 20% të punëkërkuesve** | | | | | | | | | | |
| Aktiviteti1.1 Këshillim dhe ndërmjetësim për punësim | Specialisti i mbrojtjes dhe fuqizimit ekonomik/Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale<br>Sektori i Tatim Taksave<br>Administratorët shoqëror pjesë e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit | 2021-2023 | Marrëveshja me Zyrën e Punës mundëson këshillimin pranë njësive administrative;<br>Numri i individëve të këshilluar e ndërgjegjësuar për punësim pranë çdo njësie administrative;<br>Baza e të dhënave të bizneseve dhe institucioneve e organizatave partnere e ngritur;Janë identifikuar forma të ndërveprimit mes Bashkisë-biznesit-Zyrës së Punës-dhe aktorëve të tjerë me qëllim përmbushjen e objektivit të fuqizimit ekonomik të familjeve dhe zbutjes së varfërisë në këtë Bashki;<br>Çdo vend pune i krijuar publikohet në ambjentet e Bashkisë dhe njësive administrative;<br>Numri i individëve nga grupet në nevojë të punësuar përmes masave të zbatuara të këtij Plani;<br>Programi dhe Tryeza e zhvilluar janë në përputhje me objektivin e këtij aktiviteti; | Ligji "Për asistencën sociale"<br>Ligji "Për nxitjen e Punësimit"<br>Urdhëri i Përbashkët i Ministres së Financës dhe Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi Protokollin e Bashkëpunimit mes SHSSH dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit (gusht 2019) | - | DSHS | 40,000 | 40,000 | | - |
| Aktiviteti1.2 Financim i projekteve për nxitje biznesei | Specialisti i mbrojtjes dhe fuqizimit ekonomik/Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale | 2021-2023 | Manualet për procedurat operacionale të përgatitura brenda vitit të parë të zbatimit të Planit;<br>Thirrja për aplikime është publike dhe komuniteti i targetuar është gjerësisht i informuar për hapësirat për aplikim;<br>Numri i projekteve të biznesit që aplikojnë për mbështetje;<br>Numri i projekteve fituese;<br>Numri i individëve nga grupet e targetuara (të rinj, viktima dhune, gra kryefamiljare, persona me aftësi të kufizuar) të punësuar përmes bizneseve të ngritura. | Ligji "Për asistencën sociale"<br>Ligji "Për nxitjen e Punësimit"<br>Ligji "për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara" | | | | | | - |
| Aktiviteti 1.2 Financim i projekteve për nxitje biznesei | DSHS<br>OJF | ~~2019~~ 21-23 | Numri i familjeve të mbështetura në raport me numrin e familjeve në nevojë | Sistemi i NE, Vlerësimi socio-ekonomik i administratorëve shoqërorë në çdo NJA | Donatorë, OJF | DSHS, OJF | 6,062,500 | 62,500 | | 6,000,000 |
| 1,3 Ngritje e bizneseve sociale | Specialisti i mbrojtjes dhe fuqizimit ekonomik/Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale | 2021-2023 | Numri i organizatave me të cilat Bashkia ka ndërtuar partneritet për qëllime të fuqizimit ekonomik të individëve në nevojë;<br>Numri i bizneseve sociale të ngritura në territorin e Bashkisë;<br>Numri i individëve, pjesë e grupeve në nevojë, të punësuar në biznese sociale; | Ligji "Për asistencën sociale"<br>Ligji "Për ndërmarrjet sociale | BL | DSHS | | | | |
| | | | | | | | 0 | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | 6,102,500 | 102,500 | - | 6,000,000 |

| Aktivitetet | Aktorët përgjegjës | Afatet | Treguesit | Burimi i të dhënave | Financimi | Monitorimi | Kosto | Buxheti lokal | Donatore | Hendeku I financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 1 – Brenda vitit 2023 nevojat për shërbime të emergjencës, reabilituese, zhvilluese dhe riintegruese të grupeve në nevojë do të adresohen përmes sistemit komunitar funksional të shërbimeve të kujdesit shoqëror** | | | | | | | | | | |
| Aktiviteti 1.1 Shërbime për fëmijët dhe familjen | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale<br>Ekipi i Qendrës Multifunksionale | 2020-2022 | Infrastruktura e godinës e përshtatëshme për ofrimin e shërbimeve komunitare;<br>Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik;<br>Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimeve sipas tipit të shërbimit;<br>Numri i përfituesve të shërbimeve që ofron qendra;<br>Numri i përfituesve të shërbimeve të emergjencës pranë familjeve në territorin e Bashkisë; | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"<br>VKM 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"<br>Standarti Kombëtar i miratuar me Udhëzim të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 911, datë 27.12.2018 "Për miratimin e standartit të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore" | | | 34,156,000 | | | 34,156,000 |
| Aktiviteti 1.2 Aksesueshmëria dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale<br>Në partneritet me strukturat e arsimit, shëndetësisë, zyrën e punës dhe ofruesit e shërbimeve | 2022 | Plani për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara identifikon qartësisht ndërhyrjet që duhet të kryeje çdo institucion publik, përfshirë Bashkinë, për të mundësuar respektimin e legjislacionit dhe Konventës Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësisë të Kufizuara.<br>Në mënyrë të veçantë identifikohen qartësisht godinat dhe mjediset ku duhet të ndërhyhet për t'i bërë të aksesueshme.<br>Investime të ndërmarra nga Bashkia apo sugjeruar aktorëve të tjerë publik me qëllim garantimin e aksesit të personave me aftësi të kufizuara në mjedise publike. | | | | 7,284,000 | | | 7,284,000 |
| Aktiviteti 1.3 Shërbime rehabilituese, fuqizuese, riintegruese për personat me aftësi të kufizuara | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale<br>Ekipi i Qendrës Multifunksionale për PAK | 2021-2023 | për ofrimin e shërbimeve;<br>Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik;<br>Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimeve sipas tipit të shërbimit;<br>Numri i përfituesve të shërbimeve që ofron qendra;<br>Numri i përfituesve të shërbimeve të lëvizshme;<br>Numri i familjarëve/ndihmësve të personave me aftësi të kufizuara të ëprfshirë në shërbimet e qendrës;<br>Numri i personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë nga programet e informimit, këshillimit, advokimit; | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"<br>VKM 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"<br>Ligji "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"<br>Standarti kombëtar për shërbimin në qendër ditore për personat me aftësi të kufizuara<br>Standarti kombëtar për shërbimin në familje për personat me aftësi të kufizuara; | | | 40,898,150 | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Aktiviteti 1.4 Shërbime reabilituese dhe rintegruese për viktimat e dhunës në familje | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale<br>Koordinatori vendor për masat kundër dhunës në familje | 2021-2023 | Apartamentet funksionale për çdo rast;<br>Staf i dedikuar dhe i trainuar për shërbim;<br>Numri i rasteve të akomoduara në kushtet e emergjencës;<br>Numri i rasteve që kanë përfituar shërbime reabilituese dhe riintegruese; | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"<br>Ligji "'për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare"<br>VKM 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"<br>Vendim<br>nr.505, datë 13.7.2011<br>"Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror<br>për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike<br>dhe jopublike" | | | 5,017,683 | | | |
| Aktiviteti 1.5 Shërbime për të moshuarit | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale | 2021-2023 | Infrastruktura e godinës e përshtatëshme për ofrimin e shërbimeve;<br>Shërbimet përbërëse të ngritura dhe funksionale në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik;<br>Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimeve sipas tipit të shërbimit;<br>Numri i të moshuarve që përfitojnë shërbimin rezidencial;<br>Numri i të moshuarve që përfitojnë shërbimin ditor;<br>Numri i të moshuarve që përfitojnë shërbimin në shtëpi; | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"<br>VKM 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar"<br>Standarti kombëtar për shërbimin rezidencial për të moshuarit;<br>Standarti kombëtar për shërbimin ditor për të moshuarit;<br>Standarti kombëtar për shërbimin në familje për të moshuarit; | | | 14,995,200 | | | 14,995,200 |
| Aktiviteti 1.6 Trajtimi me bonus qeraje i familjeve të pastreha dhe në situatë të vështirë ekonomike | | | | | | | 3,240,000 | 3,240,000 | | - |
| Total | | | | | | | 105,591,043 | 3,240,000 | - | 56,435,200 |

| Aktivitetet | Aktorët përgjegjës | Afatet | Treguesit | Burimi i të dhënave | Financimi | Monitorimi | Kosto | Buxheti lokal | Donatore te angazhuar | Hendeku I financimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 1. Sistemi komunitar i shërbimeve i përgjigjet cilësisht nevojave në ndryshim të grupeve vulnerabël** | | | | | | | | | | |
| Monitorimi i cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve | Punonjësi social/ Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes | 2021-2023 | Instrumentat e monitorimit të çdo shërbimi janë hartuar në përputhje me standartet | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e | BM | SSS | 551,000 | 69000 | | 482,000 |
| Rishikimi periodik i Planit Social | Drejtoria e mbrojtjes, kujdesit dhe përfshirjes sociale | 2021-2023 | Lista e treguesve që do të mblidhen; Frekuenca e mbledhjes së çdo treguesi; Burimi nga do të | Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e | | | | | | |
| Total | | | | | | | 551,000 | 69,000 | - | 482,000 |